



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 42 regjistër (JR)
Datë 17.09.2019

Nr. 28 i vendimit
Datë 23.10.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Ina Rama	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 23.10.2020, ditën e premte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Fuat Vjerdha, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 155, datë 10.06.2019.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës, nenet A, Ç, D, Dh, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, sipas të cilave kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 155, datë 10.06.2019, të Komisionit të Pavarur të

Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Fuat Vjerdha, në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur detyrën e gjyqtarit, me funksion kryetar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 (në vijim “ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe c) Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimit të të dhënave të tjera të përcjella prej agjencive ligjzbatuese, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kriterëve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin² në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit.

1.3 KLD-ja, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha, ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, të cilin ia ka përcjellë Komisionit³.

1.4 Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Fuat Vjerdha, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: kontrolli i pasurisë, i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë në përfundim të procedurës administrative vendimin nr. 155, datë 10.06.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Komisioni, me vendimin nr. 155, datë 10.06.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pikat 3, 4 e 5 të ligjit nr. 84/2016, sipas konkluzioneve vijuese.

¹ Raporti i ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 09.01.2018

² Raporti i DSIK-së i deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2018.

³ Raporti i KLD-së me nr. {***} prot., datë 04.05.2018.

2.1 Lidhur me kontrollin e pasurisë: Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme në deklaratën “vetting” dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse mospërputhjen e kësaj të fundit me deklaratat periodike, lidhur me kursimet cash dhe gjendjet likuiditet në llogaritë bankare, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; për rrjedhojë, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

2.2 Në lidhje me kontrollin e figurës: subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, për sa i përket figurës, ai konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

2.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale: Lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura, shkelje procedurale dhe gjykim i dobët, për shkak të të cilave subjekti nuk arrin nivelin kualifikues të kërkuar sipas germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2.4 Nga vlerësimi tërësor dhe kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ndaj, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

3. Subjekti i rivlerësimit, më datë 29.07.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 155, datë 10.06.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 155/1, datë 30.07.2019.
4. Në ankimin e tij, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ndryshimin e vendimit nr. 155, datë 10.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Me ankimin e tij, subjekti ka paraqitur bashkëlidhur disa komente të bëra nga individë të ndryshëm në rrjetet sociale pas shkarkimit të tij nga detyra. Më datë 24.09.2020, subjekti ka paraqitur parashtrimet e tij pranë Kolegjit, bashkëlidhur të cilave ka paraqitur një peticion të nënshkruar nga 6224 persona, pas shpalljes së vendimit nga Komisioni, të cilët janë dakordësuar me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Me parashtrimet, subjekti kërkon nga Kolegji konsiderimin e peticionit si një provë e re e nevojshme për t’u vlerësuar për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, lidhur me konkluzionet e Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
5. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha ndaj vendimit të Komisionit nr. 155, datë 10.06.2019, si shkaqe të ankimit janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë.

A. Mbi procesin e rregullt ligjor, si dhe aplikimin e ligjit material

5.1 Me vendimin e Komisionit nr. 155, datë 10.06.2019, janë cenuar një sërë parimesh të procesit të rregullt ligjor, si: (i) parimi i arsytimit të vendimit; (ii) parimi i aksesit; (iii) parimi i

kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve; (iv) parimi i prezumimit të pafajësisë; (v) parimi i pavarësisë dhe paanësisë; (vi) parimi i ligjshmërisë; (vii) parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit; (viii) parimi se ligji nuk ka efekte prapavepruese (zbatimi i ligjit në hapësirë dhe kohë).

B. Shkaqe që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë

5.2 Vendimi i Komisionit, në drejtim të kontrollit të pasurisë, është rezultat i një gjykimi të njëanshëm dhe kontradiktor, pasi në juridiksionin e këtij organi përgjatë procesit të rivlerësimit mbetet kontrolli i saktësisë dhe vërtetësisë së deklaramit të deklaratës vetting; dhe se deklaramet periodike, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nuk përbëjnë veçmas objekt kontrolli.

5.3 Konkluzioni i Komisionit lidhur me kriterin e pasurisë, është i pambështetur, i paargumentuar e i marrë në kundërshtim me provat e administruara në gjykim, pasi:

- i. referuar deklarameteve periodike, është e qartë situata lidhur me burimet e të ardhurave të përdorura për blerjen e automjetit në vitin 2014;
- ii. Komisioni, lidhur me kontrollin e pasurisë, nuk ka mundur të identifikojë asnjë pasaktësi në deklaramet e mia, si dhe nuk ka mundur të provojë se disponoj pasuri më të madhe nga sa unë kam justifikuar ligjërisht.

C. Shkaqe që lidhen me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

5.4 Qëndrimet e mbajtura për denoncimin e shtetasit R.L., që kanë të bëjnë me procedimin penal nr. {***} të vitit 2007, që u përket të pandehurve G. e V.H., janë të pabazuara, të ndryshme me standardin e mbajtur nga Komisioni në raste të tjera të ngjashme dhe në tejkalim të ligjit, pasi për këtë procedim ka edhe një vendimmarrje të shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka ndryshuar vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Shkodër.

5.5 Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, që i përket çështjes me palë të pandehur M.M. e F.M., për kryerjen e veprës penale “mashtrim”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, Komisioni, duke argumentuar cilësinë e arsytimit të vendimit, ka marrë atributet e Gjykatës së Lartë, gjë e cila është në kundërshtim me nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5.6 Për procedimin civil nr. 103 të vitit 2013, që i përket çështjes me palë ankuese R.Q. ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Shkodër, e cila ka refuzuar marrjen e masës së sigurimit të padisë, Komisioni nuk referon dispozitat ligjore të shkelura gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë.

5.7 Konstatimet e Komisionit lidhur me gjykimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2010, që i përket çështjes me të pandehur F.Sh. e F.M. për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duhen vlerësuar me proporcionalitet dhe objektivitet, pasi një rast i vetëm nuk mund të përbëjë shkak shkarkimi.

5.8 Qëndrimet e Komisionit lidhur me procedimin civil nr. {***} të vitit 2018, që i përket çështjes me palë paditëse A.Gj. e palë të paditur Bashkia Lezhë, për zgjidhje të padrejtë të marrëdhënies së punës, çështje e cila gjithashtu ka të bëjë me denoncimin e këtij shtetasi, janë të gabuara edhe sepse këto pretendime nuk mund të jenë objekt shqyrtimi, pasi çështja është ende në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë.

5.9 Qëndrimi i Komisionit lidhur me procedimin nr. {***} të vitit 2011, që i përket të pandehurit S.M., lidhur me vendimin e marrë për të nga Gjykata e Apelit Shkodër, nuk është i bazuar ligjërisht dhe konsiderimi i kësaj çështjeje si “fakt i njohur botërisht”, është një keqdashje e trupit gjykues.

Ç. Shkaqe lidhur me konkluzionin për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

5.10 Trupi gjykues, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, që është rrjedhojë e vlerësimit në mënyrë të gabuar të të gjitha provave të administruara gjatë hetimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

6. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 155, datë 10.06.2019, u mor në shqyrtim në Kolegj në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).

6.1 Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë. Subjekti, bashkëlidhur ankimit, ka paraqitur si provë të re disa komente të individëve të ndryshëm të bëra në rrjetet sociale pas dhënies së vendimit të Komisionit për shkarkimin e tij nga detyra.

6.2 Bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, subjekti ka paraqitur në Kolegj parashtrimet me shkrim 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore⁴. Bashkëlidhur me parashtrimet, subjekti ka paraqitur edhe një peticion të nënshkruar nga 6224 individë, përgjithësisht bashkëqytetarë të tij, pas shpalljes së vendimit nr. 155, datë 10.06.2019, të cilët deklarojnë se nuk janë dakord me konkluzionin e arritur nga Komisioni se subjekti me veprimet tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Lidhur me këtë peticion, subjekti pretendon se ai është një provë e re, sipas parashikimit të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, të cilën nuk ka mundur ta paraqesë gjatë procesit në Komision, për shkak se konkluzioni se ai ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë i është bërë atij prezent vetëm nëpërmjet vendimit përfundimtar të Komisionit dhe, në këto kushte, ai ka qenë në pamundësi, pa fajin e tij, për ta paraqitur këtë provë gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision.

6.3 Kolegji mori në shqyrtim këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe e vlerësoi atë në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, sipas nenit 47⁵ të ligjit nr. 49/2012, si edhe nevojën e marrjes së kësaj prove sipas parashikimeve të posaçme të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

6.4 Pavarësisht se në kuptimin formal, prova e paraqitur prej subjektit dukej se plotësonte njërin prej kritereve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, atë të mospasjes mundësi për t’u paraqitur gjatë procesit hetimor, në mungesë të dijenisë së konstatimit të shkeljes që lidhej me cenimin e besimit të publikut te drejtësia, ai nuk plotëson kriterin tjetër të parashikuar nga ko dispozitë, i cili lidhet me afatin e depozitimit të provës së re së bashku me ankimin e subjektit të rivlerësimit. Prova e re e cilësuar si “peticion” është paraqitur prej subjektit bashkë me parashtrimet e paraqitura prej tij në

⁴ Të depozituara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.09.2020.

⁵ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.”

zbatim të nenit 49/2 të ligjit nr. 49/2012, dispozitë e cila parashikon vetëm depozitim të parashkrimeve si një akt shpjegues e më i detajuar mbi ankimin objekt shqyrtimi, 5 ditë para zhvillimit të gjyqimit, por jo paraqitjen bashkë me të të provave të reja.

6.5 Kolegji, përtej arsytimit të mësipërm, vlerësoi gjithashtu edhe nevojën e marrjes së kësaj prove në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, parë lidhur me zbatimin e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke analizuar nevojën për të shqyrtuar këtë provë të re në seancë gjyqësore publike, në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arriti në konkluzionin se për shkak të rrethanave të çështjes dhe kualifikimit ligjor të tyre, të bërë në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, në referim të shkaqeve të ankimit, nuk rezultojnë rrethana të tilla lidhur me konstatimin e cenimit të besimit të publikut, për qartësimin e të cilave do të ishte e nevojshme marrja e një prove të re, prandaj u gjend se ekzistojnë kushtet për refuzimin e marrjes së kësaj prove sipas nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, vlerësimi i të gjithë situatës faktike të pranuar se ka ekzistuar prej vendimit të Komisionit, nuk u gjend i zbatueshëm asnjë prej rasteve të parashikuara prej nenit 51, pika 1, gjerat “a”, “b” e “c” të ligjit nr. 49/2012, të cilat do të prodhonin nevojën e zhvillimit të një seance gjyqësore publike për zgjidhjen e çështjes. Në këto rrethana, Kolegji vlerësoi se çështja mund të zgjidhej në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, duke u mbështetur në të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 që referon te neni 49 i ligjit nr. 49/2012.

B. *Shqyrtimi i shkaqeve që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe aplikimin e ligjit*

7. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vendimin e Komisionit nr. 155, datë 10.06.2019, janë cenuar një sërë parimesh të procesit të rregullt ligjor, si: (i) *parimi i arsytimit të vendimit*; (ii) *parimi i aksesit*; (iii) *parimi i kontradiktorialitetit dhe barazisë së armëve*; (iv) *parimi i prezumimit të pafajësisë*; (v) *parimi pavarësisë dhe paanësisë*; (vi) *parimi i ligjshmërisë*; (vii) *parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit*; (viii) *parimi se ligji nuk ka efekte prapavepruese (zbatimi i ligji në hapësirë dhe kohë)*, Kolegji konstaton, nga analizimi i të gjitha akteve të administruara në fashikullin e krijuar nga Komisioni, se mes subjektit dhe Komisionit, përgjatë hetimit administrativ, ka pasur një komunikim të vazhdueshëm. Komunikimi ka vazhduar edhe pas riçeljes se hetimit dhe nxjerrjes së një raporti shtesë për hetimet parapake, duke i kaluar sërish subjektit barrën e provës për disa elemente të reja të gjetura pas riçeljes. Nga aktet konstatohet se subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova që janë analizuar dhe vlerësuar nga Komisioni, si dhe për të janë zhvilluar 2 (dy) seanca dëgjimore publike, në të cilat subjekti ka shpjeguar gjerësisht qëndrimet e argumentet e tij, të cilat janë disa elemente që, në tërësinë e tyre, dëshmojnë se Komisioni në vija të përgjithshme është përpjekur të zbatojë parimet kryesore të procesit të rregullt, siç është ai i garantimit të së drejtës për t’u njohur me provat, për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur.

7.1 Kolegji gjithashtu konstaton se, pavarësisht se subjekti në ankim nuk specifikon veprimtari konkrete procedurale e cila të bashkëlidhet me shkeljen e parimeve të mësipërme, për shkak të arsytimit mbi shkaqet e tjera të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë, aftësisë profesionale dhe cenimit të besimit të publikut të drejtësia, trajtimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me procesin e rregullt ligjor do të kryhet në mënyrë të integruar me shkaqet e tjera që lidhen me themelin e çështjes, të cilat do të analizohen në arsytimin në vijim.

C. *Shkaqe që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë*

8. Subjekti ka pretenduar në ankim se *vendimi i Komisionit në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë është rezultat i një gjykimi të njëanshëm dhe kontradiktor, pasi në juridiksionin e këtij organi përgjatë procesit të rivlerësimit mbetet kontrolli i saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të*

deklaratës vetting; dhe se deklarimet periodike në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nuk përbëjnë veçmas objekt kontrolli. Subjekti ka kontestuar qëndrimin e mbajtur nga Komisioni për deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me mungesën e deklarimit të burimit të krijimit të pasurisë “automjet” në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2014, duke shpjeguar se burimi për fitimin e kësaj pasurie është nga kursimet e tij dhe se ai gjendet në kushtet e pasjes së burimeve të ligjshme për të blerë këtë pasuri, ndërsa mosdeklarimi i burimit në deklaratën e këtij viti është thjesht një pasaktësi që nuk mund të jetë shkak shkarkimi.

8.1 Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *vetting*, që i përket subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se ai ka deklaruar në pronësi të tij, përveç të tjerave, dy pasuri të cilat, pasi janë bërë objekt verifikimi e kontrolli prej Komisionit, kanë rezultuar me problematika sipas vlerësimit të tij. Për këto pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzione që kanë shërbyer si bazë për qëndrimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë dhe se ndaj tij ka vend për zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, që shkakton si pasojë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Këto pasuri janë:

- a) autovetura e markës “Daimler-203-CDI”, prodhim i vitit 2001, blerë në datën 16.04.2014, me vlerë 290000 lekë;
- b) gjendja *cash* në shtëpi, në vlerën prej 200000 lekësh.

8.2 Komisioni në vendimin e tij ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer pasaktësi në deklaratën periodike të vitit 2014, pasi nuk ka deklaruar në të burimin e krijimit të autoveturës së markës “Daimler-203-CDI” por, pavarësisht këtij konkluzioni, Komisioni nuk e ka konsideruar këtë gjetje si një shkak që mund të ngrihet në nivelin e një shkak shkarkimi.

8.3 Në këto rrethana, duke konsideruar edhe shkaqet e ankimit dhe paqartësinë që vjen nga mënyra se si është shprehur Komisioni për këtë shkak, Kolegji e gjen me vend ta analizojë atë në raport me konkluzionin se pasaktësia i përket deklaratës periodike vjetore të vitit 2014 dhe konkluzionit të përgjithshëm se, në vlerësimin tërësor, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në këtë kontekst, Kolegji analizoi deklaratën e pasurisë së subjektit që i përket deklarimit periodik të vitit 2014, në të cilën ai ka deklaruar edhe blerjen e kësaj autoveture, me vlerë 290000 lekë, në datën 16.04.2014.

8.4 Nga analiza e akteve të administruara gjatë hetimit, dhe konkretisht përgjigjeve të pyetësorëve drejtuar subjektit prej Komisionit, rezulton se ai në përgjigje të pyetjes se me çfarë të ardhurash e ka financuar blerjen e kësaj autoveture, është përgjigjur se si burim për këtë financim kanë shërbyer kursimet e tij të vitit të mëparshëm ⁶.

8.5 Nga analiza financiare e kryer në Komision, por edhe në Kolegji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme në vitin 2014, të disponuara prej tij, të cilat mundësonin blerjen e autoveturës, por edhe mbulonin me të ardhura të ligjshme të gjitha shpenzimet e kryera prej tij këtë vit. Në të dyja analizat financiare të kryera në lidhje me këtë vit, referuar deklarimeve periodike të tij në DPV-në e vitit 2014, përdorur si provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se subjekti ka pasur një vlerë të ndryshimit të likuiditetit në masën 1.603.666 lekë, sipas analizës së Komisionit dhe në vlerën 1.893.665 lekë, sipas analizës së Kolegjit, e cila nënkupton pakësimin e të ardhurave *cash*, të cilat mund të kenë shërbyer për financimin e shpenzimeve të ndryshme, përfshirë edhe blerjen e autoveturës.

⁶ Në shpjegimet e tij për rezultatet paraprake të hetimit të datës 29.04.2019, subjekti i rivlerësimit ka shprehur se: “Autoveturën e markës Dimler 203 CDI, me ngjyrë gri, të vitit 2001, me targë {***}, e blerë më datën 16.04.2014, është blerë me të ardhurat që kam përfutuar. Këtë e kam deklaruar në deklaratën e datës 27.03.2015 (faqe nr. 3)”.

8.6 Në këtë kuptim, qartazi, si në Komision, edhe në Kolegj, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të financuar blerjen e autoveturës në vitin 2014, në vlerën 290000 lekë. Në këtë situatë faktike, pavarësisht konstatimit se subjekti nuk ka plotësuar kërkesën e nenit 4, paragrafi i parë i ligjit nr. 9043/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9043/2000”), Kolegji çmon se kjo mangësi në zbatimin e ligjit nuk mund të shërbejë si një shkak për të konsideruar apo prezumuar vendosjen e masës disiplinore. Kjo situatë, në vlerësimin e Kolegjit, duke u mbështetur edhe mbi jurisprudencën e deritanishme e të konsoliduar tashmë të tij⁷, është e tillë që nuk mund të shërbejë si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat do sillnin si pasojë zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

8.7 Në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni, për sa i përket mosngritjes së kësaj pasaktësie në nivelin e një shkak shkakimi në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, por, në mungesë të referencës së shprehur, trupi gjyqësor i Kolegjit dedukton se duket sikur Komisioni e ka përdorur këtë gjetje, ndonëse jo në mënyrë të shprehur, si një shkak që mund të shërbejë në analizë të vlerësimit tërësor e të përgjithshëm të tri kriterëve, për të cilën Komisioni ka konkluduar se ekzistojnë shkaqe që të arrihet në përfundimin se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

8.8 Kolegji, duke konfirmuar qëndrimin e Komisionit për sa i takon sa më lart, e sheh të nevojshme të analizojë këtë rrethanë në kuadër të trajtimit të shkakut të ankimit që lidhet me cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë në arsyetimin në vijim, analizë e cila është e orientuar edhe drejt konsiderimit të kësaj rrethane në vlerësimin e këtij shkak.

8.9 Në vijim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me kontrollin e kriterit të pasurisë, Kolegji konstaton se shkak i vetëm i rëndësishëm për vendimmarrjen e Komisionit në lidhje me këtë kriter, lidhet me kontestimin e konkluzionit të Komisionit se: *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme në deklaratën “vetting” dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse mospërputhjen e kësaj të fundit me deklaratat periodike, lidhur me kursimet cash dhe gjendjet likuiditet në llogaritë bankare, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; për rrjedhojë, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaratimit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

8.10 Në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit, pasqyrohet argumenti se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në bazë të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 për sa i përket pasurisë se tij likuiditet në formën *cash*, në vlerën 200000 lekë të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* në dy mënyra alternative: i) ose duke bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë *vetting* për mosdeklarimin e posedimit të likuiditeteve në shumën prej 1.683.129 lekësh ose ii) ka kryer së paku katër deklarime vjetore të pamjaftueshme që lidhen me shumën *cash* të deklaruar jo me vërtetësi duke mos i poseduar ato realisht. Në vlerësim të këtij shkak shkakimi, i cili mbetet i vetmi shkak shkakimi i konsideruar prej Komisionit në lidhje me kontrollin e kriterit të pasurisë, Kolegji analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit për sa i përket pasurisë së tij në formë likuiditeti, të kryera në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike të pasurisë në vite. Nga verifikimi i këtyre akteve, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si pasuri të tij në formë likuiditeti: i) depozitë bankare pranë First Investment Bank Albania ShA, në vlerën 1.000.000 lekë, me burim të krijimit kursimet ndër vite të pasqyruara në deklarata vjetore; ii) llogari page pranë Raiffeisen Bank, në shumën 276.802 lekë; dhe iii) gjendje *cash* në shtëpi rreth 200.000 lekë.

⁷ *Shih vendimet e Kolegjit nr. 9/2020 (JR), datë 26.06.2020; nr. 16/2020 (JR), datë 13.07.2020.*

8.11 Sipas analizës financiare të kryer në Komision, subjekti i rivlerësimit, referuar deklarimeve të tij periodike në lidhje me pasurinë likuiditet, duhej të kishte akumuluar gjendje në kohën e përpilimit të deklaratës së pasurisë *vetting* shumë prej 1.683.129 lekësh, dhe pikërisht kjo mospërputhje mes shifrës së kalkuluar prej Komisionit në analizë të deklarimeve periodike dhe asaj të deklaruar prej subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting*, përbën edhe shkakun kushtetues e ligjor të përdorur për shkarkimin e tij në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë për llogari të këtij procesi. Komisioni e ka konstatuar këtë gjetje si një shkak për të cilin i është kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit pas riçeljes së hetimit administrativ me vendimin nr. {***}, datë 06.05.2019, vendim i marrë prej Komisionit pas depozitimit të një denoncimi ndaj subjektit të rivlerësimit që lidhej me kriterin e aftësive profesionale.

8.12 Në lidhje me këtë çështje, Kolegji, duke analizuar deklaratat periodike të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, konstaton se duke filluar që nga viti 2007 deri në vitin 2015, ai ka deklaruar kursime vjetore, në të cilat, sipas shpjegimeve të tij, pas rezultateve parapake të hetimit, ai ka përfshirë likuiditet të gjendura në llogaritë bankare e gjendjet *cash* në banesë. Komisioni në vendimmarrjen e tij e ka pranuar si të vërtetë e bindës këtë shpjegim dhe ka ndërtuar analizën financiare duke e konsideruar këtë rrethanë në këtë mënyrë. Pas kryerjes së analizës financiare, sipas Komisionit, duke llogaritur dhe mbledhur shumat e deklaruara prej subjektit si gjendje *cash* në banesë, ai duhej që potencialisht të kishte në banesë në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting* shumë prej 1.683.129 lekësh, ndërkohë subjekti ka deklaruar se ka gjendje vetëm shumë prej 200.000 lekësh.

8.13 Për këtë mospërputhje në përgjigje të barrës së provës së kaluar subjektit pas riçeljes së hetimit administrativ, subjekti ka dhënë shpjegime duke pretenduar se ai në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting* ka pasur realisht gjendje *cash* vetëm shumë e deklaruar në këtë deklaratë dhe se likuiditetet e akumuluar në vite e të përlllogaritura prej tij gjendje e disponueshme prej subjektit, janë disponuar realisht nga babai i subjektit i cili jeton me të. Përpos dhe në mbështetje të këtij argumenti, subjekti ka paraqitur disa akte shkresore që tregojnë për faktin se babai i subjektit zotëron depozita bankare dhe ka kryer disa pagesa duke përdorur pikërisht këto të ardhura të transferuara nga subjekti tek ai, për shkak të marrëdhënieve të posaçme dhe jetesës në një familje, duke qenë se subjekti është fëmijë i vetëm.

8.14 Kolegji, në funksion të zgjidhjes së kësaj çështjeje, analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike dhe deklaratimet dhe shpjegimet e dhëna prej tij gjatë procesit të rivlerësimit në këndvështrim të detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore, për të provuar bindshëm ligjshmërinë e krijimit të pasurisë. Nga analizimi i këtyre deklaratave, rezulton se subjekti ka deklaruar nën emërtimin “kursime të realizuara nga të ardhurat vjetore” në shumat respektive⁸ nga viti 2008 deri në vitin 2014 shtesat e pasurisë likuiditet në rubrikën “Ndryshimet e pasurisë dhe burimi i krijimit” në deklaratat periodike vjetore. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2014, krahas deklaratimit për kursimet vjetore në shumë respektive, subjekti ka deklaruar në të njëjtën rubrikë edhe gjendjen në *cash*, në vlerën 195.000 lekë.

8.15 Duke vlerësuar të gjitha të dhënat e administruara përgjatë hetimit administrativ në lidhje me kontrollin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, Kolegji çmon të veçojë disa elemente të cilat u konsideruan prej tij të rëndësishme për sa i përket zgjidhjes së çështjes së shtruar në raport me vlerësimin e këtij kriteri.

Së pari, u konstatua se qoftë nga analiza financiare në Komision, qoftë nga ajo e kryer në Kolegji, subjekti i rivlerësimit kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të përballuar të gjitha

⁸ Shih të dhënat në poshtëshënimin 9 vijues.

shpenzimet e kryera prej tij e pasuritë e krijuara me burim këto të ardhura, në secilin prej viteve në të cilin janë kryer deklaratimet periodike, të dhëna të cilat i janë nënshtruar analizës financiare në të dy organet Nga verifikimi i këtyre deklaratimeve dhe analiza e tyre, nuk rezultojnë diferencë negative në analizën e subjektit për asnjërin prej viteve të deklaratimit, për pasojë, të gjitha pasuritë e krijuara, përfshirë edhe ato në likuiditet, të cilat në rastin konkret janë e vetmja pasuri e subjektit të rivlerësimit, së bashku me automjetin e markës “Daimler Chrysler”, të krijuara me të ardhurat e familjes së tij nga punësimi. Për pasojë, subjekti plotëson në këtë mënyrë detyrimin kushtetues të provimit të burimit të ligjshëm të pasurive të tij, sipas kërkesave të nenit D, pikat 1 e 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Së dyti, nuk rezultojnë asnjë e dhënë e dalë gjatë deklaratimeve në deklaratat periodike dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ në Komision se subjekti ka përdorur pasurinë e tij likuiditet për të krijuar ndonjë pasuri apo për të përballuar ndonjë shpenzim përgjatë periudhës që i është nënshtruar kontrollit. Në këto kushte, kur shpenzimi apo përdorimi i këtyre pasurive, të deklaruara *cash* e të justifikuar ligjërisht, nuk ka shërbyer si burim krijimi për asnjë pasuri të krijuar prej subjektit apo për të përballuar ndonjë transaksion financiar të kryer prej tij, situatë faktike e cila do të kërkonte domosdoshmërisht saktësinë e deklaratimeve periodike të subjektit për vlerën e kësaj pasurie, sipas kërkesës së nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji çmon se pasaktësia e këtyre deklaratimeve nuk afekton verifikimin e ligjshmërisë së burimit për të gjitha pasuritë e subjektit.

Së treti, në vlerësim të deklaratimeve të subjektit në deklaratat periodike e në mënyrë të veçantë në atë të vitit 2014, duket se subjekti i rivlerësimit specifikon se në këtë vit, përveç kursimeve të krijuara nga pagat në vlerën prej 500.000 lekësh, ka deklaruar si pasuri likuiditet një gjendje në *cash*, në vlerën prej 195.000 lekësh. Nga leximi i kësaj deklarate, duket se pavarësisht kursimeve të deklaruara në vite dhe të mbartura në deklarime vit pas viti, në vitin 2014 subjekti ka pasur një gjendje të pasurisë likuiditet në *cash*, në vlerën e deklaruar prej tij 195.000 lekë, pavarësisht se ai nuk ka deklaruar se vlera e gjendjes *cash* të akumuluar potencialisht në vite është pakësuar në çfarëdolloj mënyre e për çfarëdolloj arsyeje. Pavarësisht faktit se subjekti në deklaratimet e tij shpjeguese përgjatë hetimit administrativ, por edhe në ankim, nuk e përdor këtë fakt si një argument të posaçëm që do u jepte kuptim deklaratimeve të tij, Kolegji vlerëson ta evidentojë këtë situatë që u referohet pikërisht deklaratimeve të vetë subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2014. Nëse do të vazhdohej leximi i deklaratës pasardhëse periodike, të vitit 2015, në të cilën subjekti deklaroi kursime nga të ardhurat e vitit, në masën prej 200.000 lekësh, përfshirë këtu kursimet në llogari bankare në vlerën 200.000 lekë, pakësim të llogarisë bankare në vlerën (-)19.439 lekë, si dhe gjendje *cash* të mbetura si diferencë prej (+) 19.439 lekësh, si edhe leximi i deklaratës periodike të vitit 2016, në të cilën subjekti nuk deklaroi shtesa apo ndryshime në pasurinë likuiditet, rezultojnë shifra prej 200.000 lekësh, e deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting*, paraqet me luhatje të vogla shumë aritmetike⁹ të deklaratimeve të tij në periudhën 2014-2016. Vetë Komisioni

⁹ Shumat e deklaruara si kursime çdo vit nga subjekti, sipas deklaratave të pasurisë, janë: viti 2008 - 500.000 lekë; viti 2009 - 500.000 lekë; viti 2010 - 400.000 lekë; viti 2011 - 500.000 lekë; viti 2012 - 500.000 lekë; viti 2013 - 500.000 lekë; viti 2014 - 500.000 lekë.

• Në vitin 2014, subjekti rezultoi të ketë në total: gjendje në llogari kursimi pranë Raiffeisen Bank, shumë prej 2.200.000 lekësh; gjendje në llogarinë e pagës pranë Raiffeisen Bank, më datë 31.12.2014, shumë prej 138.747 lekësh; pakësim të gjendjes së *cash*-it të akumuluar gjatë viteve, shumë prej 1.565.617 lekësh, dhe gjendje *cash* në fund të vitit 2014 shumë prej 195.000 lekësh.

• Në vitin 2015 subjekti ka deklaruar shtesë likuiditeti në shumë 200.000 lekë, e cila konstatohet se ka ndryshuar gjendjen e llogarisë së kursimit pranë Raiffeisen Bank, në vlerën totale prej 2.400.000 lekësh; llogaria e pagës pranë Raiffeisen Bank është pakësuar me shumë 19.439 lekë (në total, gjendja e llogarisë së pagës më datë 31.12.2014, është 119.308 lekë), shumë e cila sipas veprimeve aritmetike ka ndryshuar gjendjen e *cash*-it në dispozicion të subjektit duke shtuar atë me shumë 19.439 lekë (në total, gjendja e *cash*-it rezultoi të jetë shuma prej 214.439 lekësh).

ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në lidhje me këtë analizë, ndërkohë që pranon këtë lexim logjik të deklarimeve kur analizon vitin financiar 2014, për sa kohë që pranon se në këtë vit ka ndryshim likuiditeti në vlerën prej 1.603.666 lekësh, që do të thotë se e lexon gjendjen *cash* të deklaruar në këtë vit, prej 195.000 lekësh, si pakësim të gjendjes *cash* të akumuluar në vite sipas deklarimeve. Ndërkohë vërehet se e humbet këtë logjikë leximi e interpretimi, edhe për shkak të deklarimit jo të saktë të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2014, për vitet pasardhëse deri në deklaratën *vetting*, duke vazhduar të lexojë si gjendje potenciale *cash* për subjektin, shumat e *cash*-it të deklaruar vit pas viti, e duke abstraguuar deklarinimin e vitit 2014 në të cilin subjekti ka deklaruar një gjendje *cash* në vlerën 195.000 lekë, e cila duhej lexuar se është gjendja *cash* në këtë vit.

Së katërtri, Kolegji nga analizimi i shpjegimeve të subjektit, të dhëna gjatë hetimit por edhe në ankim, konstaton se ai e lidh përdorimin dhe pakësimin e gjendjes së tij *cash* në vite me kalimin apo dhënien në përdorim të këtyre shumave babait të tij, i cili nga ana e vet ka përdorur dhe disponuar mbi këto para nëpërmjet vendosjes së një pjese të tyre në depozitë bankare ndër vite¹⁰, e një pjese në kryerjen e disa shpenzimeve prej tij për nevoja të familjes. Pavarësisht se subjekti nuk ka përcaktuar një kohë të caktuar se kur ai e ka kaluar posedimin e kësaj pasurie te babai i tij, Komisioni ka arsyetuar mbi këto shpjegime, duke analizuar momentet kohore të përdorimit të këtyre parave si momentet kohore të kalimit të tyre nga subjekti te babai i tij. Kolegji, duke analizuar këto rrethana, vlerëson se shpjegimet e subjektit në këtë drejtim duhen konsideruar e trajtuar në drejtim të faktit që ato synojnë të provojnë se këto para i janë kaluar për administrim babait të subjektit e, për pasojë, nuk janë poseduar e zotëruar më prej tij, prandaj dhe subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* vetëm atë pjesë të pasurisë që ai zotëronte realisht. Kolegji, ndryshe nga Komisioni në këtë drejtim, nuk u jep të njëjtën vlerë provuese e interpretim të njëjtë, kohës në të cilën babai i subjektit ka lënë gjurmë të zotërimit të këtyre vlerave monetare, por i përdor këto fakte në arsyetimin e tij vetëm për të mbështetur e për t'i dhënë shpjegim faktit që subjekti nuk i posedonte realisht këto pasuri. Kolegji çmon se, pavarësisht mënyrës dhe shpjegimit që subjekti ka dhënë për përdorimin e tyre, ky element nuk prodhon ndonjë pasojë apo efekt të rëndësishëm mbi analizën e Kolegjit për sa i përket zotërimit të pasurisë likuiditet, për të cilën është konstatuar se subjekti ka pasur burime të ligjshme për ta krijuar dhe mund të disponohet në secilën formë që zotëruesi i saj, në këtë rast subjekti i rivlerësimit, do të çmojë të arsyeshme. Në vlerësimin e Kolegjit, përpjekja e subjektit në këtë rast, duke shpjeguar se kjo pasuri është disponuar prej babait të tij, pasqyron ekspozimin e një logjike për moszotërimin e kësaj pasurie, por që nuk ndikon në këndvështrimin e Kolegjit në përcaktimin e ndonjë përgjegjësie që lidhet me procesin e rivlerësimit, për sa kohë që nuk ka dyshime për justifikimin e saj me të ardhura të ligjshme.

Së pesti, nga i gjithë hetimi administrativ nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që të tregojë apo të japë edhe indicie për ndonjë situatë faktike që tregon për pasjen prej subjektit të ndonjë shume monetare

• Në vitin 2016 subjekti rezulton të ketë të pandryshuar gjendjen e llogarisë së kursimit në masën 2.400.000 lekë , gjendjen e *cash*-it të akumuluar në masën 214.439 lekë, si dhe gjendjen e llogarisë së pagës pranë Raiffesen Bank, në shumën 317.334 lekë (e shtuar me rreth 200.000 lekë).

¹⁰ 1. Sipas korrespondencës, datë 20.02.2018, me prot. no. {***}, me Bankën Kombëtare Tregtare, shtetasi S.V. disponon llogari aktive me reference {***} në shumën 6.234 USD.

2. Account of a Customer (llogaria e klientit S.V.) e datës 11.10.2016, lëshuar nga FIBANK Shkodër, me gjendje 634.283 lekë.

3. Mandatarkëtimi nga S.V., i datës 10.08.2017, në shumën 1.100 euro, ekuivalente me 143.000 lekë.

4. Faturë tatimore shitjeje, me blerës S.V., e datës 05.09.2017, në vlerën prej 135.000 lekësh.

5. Kupon tatimor i datës 05.09.2017, në vlerën 135.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shuma e disponuar prej të atit përbëhet nga: 700.000 lekë (ekuivalente me 6.234 USD) + 634.283 lekë + 143.000 lekë + 135.000 lekë = 1.612.283 lekë.

më të madhe se ajo e deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting*. Vetëm mospërputhja që vjen nga akumulimi potencial i shumave të deklaruara si *cash* në vite, që nuk deklarohen se ekzistojnë në momentin e përpilimit të deklaratës *vetting*, nuk provon pavërtetësinë e këtij deklarimi dhe të kundërtën e asaj që deklaroi subjekti. Në këtë logjikë, sipas vlerësimit të Kolegjit, konkluzioni i Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, pasi në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar realisht shumën *cash* që disponon, është një konkluzion i pambështetur në ndonjë dhënë të dalë nga ndonjë provë që provon pikërisht këtë fakt. Kjo mënyrë të interpretuari mbetet thjesht matematikore dhe jologjike apo e mbështetur në një vlerësim të harmonizuar të rrethanave, të kuadrit ligjor e të qëllimit të procesit të rivlerësimit.

Së gjashti, Kolegji, nga analiza e gjitha fakteve dhe rrethanave të cituara më lart, vlerëson se qëndron pjesërisht konkluzioni i Komisionit, për sa i përket alternativës tjetër të krijimit të kësaj mospërputhjeje, asaj të deklarimeve të pasakta nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike. Edhe në këtë pikë, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit, i analizuar në këndvështrim të përmbajtjes së të gjitha deklaratave periodike të përmendura më lart, duhej të ishte fokusuar në pasaktësitë e konstatuara në deklaratën periodike të vitit 2014, në të cilën subjekti i rivlerësimit pa deklaruar pakësime të gjendjes së *cash*-it shprehimisht, ka përpiluar një deklarim për gjendje të *cash*-it shumë më të ulët se ajo që ai duhet të kishte pasur në rast se shumatat do të akumuloheshin pa u përdorur. Në këtë deklaratë, Kolegji çmon se subjekti duhej të ishte shprehur qartë për pakësimin e gjendjes së *cash*-it dhe jo vetëm të kishte pasqyruar gjendjen e reduktuar të *cash*-it, në zbatim të detyrimeve që vijnë nga neni 4, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003. Pavarësisht këtij arsytimi, Kolegji çmon se edhe në versionin që do të qëndronte konkluzioni i Komisionit se subjekti në të paktën katër deklarata periodike ka deklaruar në mënyrë të pasaktë gjendjen e tij të *cash*-it, për sa kohë që këto pasaktësi nuk shoqërohen me mungesa të burimeve të ligjshme për të krijuar pasurinë *cash* apo pasuri të tjera të deklaruara vit pas viti, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

8.16 Në përfundim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit Fuat Vjerdha ka provuar bindshëm burimet e ligjshme të pasurive tij dhe ka provuar bindshëm vërtetësinë e deklarimeve të tij duke arritur në këtë mënyrë një nivel të besueshëm në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, në kuptim të parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

Ç. Shkaqe që lidhen me kontrollin e aftësive profesionale

9. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar me ankim qëndrimin e Komisionit në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mangësi profesionale të përsëritura, shkelje procedurale dhe gjykim të dobët për shkak të të cilave ai nuk arrin nivelin kualifikues të kërkuar sipas germës “c” të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, është gjendur i drejtë aplikimi i pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 që e konsideron atë të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

9.1 Subjekti u është referuar në mënyrë të posaçme qëndrimeve të Komisionit rreth çështjeve të veçanta të analizuara gjatë hetimit administrativ e për të cilat subjektit i është kaluar edhe barra e provës, duke dhënë qëndrimin e tij për çdo çështje të shtruar për vlerësim, por ai ka parashtruar edhe një kontestim përgjithësues të qëndrimin të Komisionit duke e konsideruar atë të njëanshëm, paragjykes, me dy standarde, referuar qëndrimeve të mbajtura në trajtimin e rasteve të ngjashme për subjekte të tjera, shkelje të cilat në vetvete, sipas subjektit, kanë prodhuar si rezultat kryerjen e

një procesi jo të rregullt ligjor ndaj tij, që ka çuar Komisionin në një konkluzion të deformuar në lidhje me kriterin e aftësive profesionale.

9.2 Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, konstatohet se krahas vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit, referuar analizimit të 3 (tri) dokumenteve të paraqitura prej vetë subjektit dhe atyre të shortuara sipas një shorti rastësor, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, duke përfshirë edhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së, vlerësim i cili nuk paraqet gjetje apo problematika të cilat kanë afektuar vendimin e Komisionit në lidhje me këtë kriter, me përjashtim të mangësive në aftësitë organizative, peshën më të rëndësishme dhe determinuese për vlerësimin e ka zënë analiza e 6 (gjashtë) çështjeve të veçanta, të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të Komisionit.

9.3 Kolegji mori në shqyrtim, në drejtim të vlerësimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me këtë kriter, gjetjet dhe konstatimet e Komisionit duke i analizuar ato në raport me rrethanat konkrete të çdo çështjeje të marrë në analizë, si edhe të kuadrit ligjor në fuqi që ka përcaktuar zgjidhjen e tyre, parë e vlerësuar e gjithë kjo situatë në raport me detyrat e kompetencat e organeve të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit në një zbatim sa më të drejtë e në përputhje me qëllimin kushtetues të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, neneve 72-76 të ligjit nr. 96/2016 e në konsideratë edhe të arsytimit të përdorur prej Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 2/2017, në të cilin janë trajtuar çështje të procesit të rivlerësimit në kontekstin kushtetues.

9.4 Nga arsytimi i vendimit të Komisionit, Kolegji konstaton se në pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale, referuar burimeve të ligjit nr. 84/2016 e të ligjit nr. 96/2016, në të cilën janë përcaktuar e përshkruar aftësitë e subjektit sipas kriterëve të vlerësimit parashikuar në nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016, gjetja e vetme e cila referon te mangësitë profesionale të subjektit lidhet me indikatorin e aftësive organizative, e konkretisht: i) me fillimin e katër seancave gjyqësore me 10 minuta vonese, si edhe ii) me mungesën në dosjet gjyqësore të vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e përfshirjes në fashikull të një relacioni me shkrim për çështjen në rastet kur ai ka qenë me cilësinë e relatorit.

9.5 Në lidhje me këto gjetje, Kolegji vëren se dokumentet e analizuara e të shqyrtuara si pjesë e këtij vlerësimi janë ato të parashikuara nga nenet 41, pika 3 dhe 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave ato i përkasin periudhës së rivlerësimit, e përcaktuar si tetor 2016 deri më tetor 2013. Përcaktimi i periudhës së rivlerësimit në këtë rast merr relevancë në vlerësimin e Kolegjit, për të vlerësuar mangësitë profesionale të subjektit të pasqyruara në vlerësimin e bërë nga Komisioni në drejtim të indikatorit të aftësisë profesionale në raport me ligjin e zbatueshëm të kohës, përkatësisht Kodi i Procedurës Civile e Kodi i Procedurës Penale në gjendjen e tyre para ndryshimeve të fundit që këto kode pësuan, përkatësisht me ligjin nr. 37/2017¹¹ e ligjin nr. 39/2017¹².

9.6 Kolegji vëren se mangësia e pasqyruar e që lidhet me fillimin me vonesë prej 10 minutash të katër seancave gjyqësore, përpos faktit që është një vonesë jodomethënëse dhe përkufizuese e tipologjisë së një organizmi defektoz të punës, nuk rezulton të ketë as qartësi se në çfarë kushtesh ka ndodhur. Kjo gjetje, ndonëse nuk vihet në diskutim për sa i përket ekzistencës së faktit dhe detyrimit të gjyqtarit për të filluar gjykimin në orën e caktuar sipas detyrimeve të rregullave të etikës e parimit të mirëpranuar mbi solemnitetin e seriozitetin e sjelljes gjyqësore të magjistratit¹³,

¹¹ Ligji nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”.

¹² Ligji nr. 39/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

¹³ Shih vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 238/1/b, datë 24.12.2008, “Për solemnitetin e gjykimin dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”:

në vlerësimin e Kolegjit, nuk mund të jetë në element i cili përcakton vlerësimin e indikatorit të aftësisë organizative, qoftë për shkak të kohës së shkurtër, qoftë për shkak të faktit se ajo mund të ketë ardhur edhe për shkaqe të justifikuara (vonesë gjykimesh të tjera, problematika logjistike etj.), të cilat nuk janë verifikuar gjatë procesit, qoftë edhe për shkak të numrit jo të lartë të rasteve të verifikuara, të cilat jo detyrimisht përcaktojnë këto episode si sjelljen e zakonshme të magjistratit në këtë drejtim.

9.7 Për sa i përket konstatimit tjetër të Komisionit në lidhje me këtë indikator, atij të mungesës së një vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, në mungesë të një parashikimi të qartë për mënyrën e vënies në lëvizje të çështjeve gjyqësore e një roli procedural të kryetarit të gjykatës në shpalljen e listave për gjykim të çështjeve, si edhe mungesës së një relacioni të shkruar në dosje, në një kohë kur dispozitat procedurale të kohës, por edhe ato të ndryshuara e që janë sot në fuqi, nuk kanë një parashikim të tillë eksplícit, Kolegji i vlerëson si mangësi të cilat edhe nëse do të konsideroheshin, nuk ka rezultuar se kanë sjellë pasoja për zhvillimin e gjykimit dhe mbarëvajtjen e tij, duke mos cenuar në këtë mënyrë ndonjë të drejtë të palëve pjesëmarrëse.

9.8 Për shkaqet e mësipërme, këto konstatime/gjetje të Komisionit nuk konsiderohen nga Kolegji për nga pesha e rëndësisë së tyre dhe pasojave që ato kanë pasur në mbarëvajtjen e proceseve, se mund të përcaktojnë vlerësimin e subjektit të rivlerësimit me mangësi në aspektin e indikatorit të aftësive organizative, sipas parashikimit të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

9.9 Kolegji, duke marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit për çështjet e tjera të analizuara e vlerësuara prej Komisionit e të paraqitura pranë tij nga denoncimet e publikut sipas parashikimit të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, arsyetoi si vijon për secilën prej tyre, duke i trajtuar ato në mënyrë të veçantë dhe duke ndjekur të njëjtën renditje si ajo e pasqyruar në vendimin e Komisionit.

10. *Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017 që u përket të gjykuarve M.M. e F.M., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në mënyrë të përmbledhur se Komisioni, duke argumentuar cilësinë e arsytimit të vendimit, ka marrë atributet e Gjykatës së Lartë, gjë që është në kundërshtim me nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

10.1 Komisioni ka marrë në shqyrtim dhe analizë këtë procedim penal, për të cilin është marrë vendimi nr. {***}, datë 18.10.2017, i Gjykatës së Apelit Shkodër, në trupën gjykuese të të cilit ka qenë me cilësinë e gjyqtarit kryesues subjekti i rivlerësimit. Sipas vendimit të Komisionit, lidhur me këtë çështje, është analizuar dhe konkluduar në mënyrë të përmbledhur se: *Për sa më lart, Komisioni ka konstatuar mangësi profesionale, të konkretizuara në: mosvlerësim të të gjitha provave të administruara në dosje; arsyetim të dobët në vendim – kryesisht me shkaqet për të cilat z. F.M. duhej të mos konsiderohej i përfshirë në mashtrimin objekt gjykimi; mosveprime për plotësimin e akuzës edhe me veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, të akteve noteriale, të vulave dhe të certifikatave të pronësisë – ndonëse këto ishin të provuara nga dokumentacioni i administruar në dosje – dhe në mosvlerësimin objektiv dhe koherent të disa rrethanave, si dhe në aplikimin jokorrekt të disa dispozitave ligjore – të cilat nuk rezultojnë në përputhje me provat dhe me rrethanat e kristalizuara nga hetimet dhe të pasqyruara në dokumentacionin e administruar në dosjen në fjalë.*

10.2 Në lidhje me këto konkluzione të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, duke kundërshtuar në tërësi qëndrimin e Komisionit, ka parashtruar në ankim një sërë pretendimesh të cilat do të

<http://arkiva.klgi.al/korniza-ligjore/akte-n%C3%ABnligjore/vendime-an/vendim-nr-238-1-b,-dat%C3%AB-24-12-2008>

analizohen nga Kolegji në vijim, duke u integruar me trajtimin e rrethanave të faktit e dispozitive ligjore të zbatueshme për sa kohë që në mënyrë thelbësore, pretendimet e subjektit gjenden të drejta në raport me këtë konkluzion.

10.3 Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se të gjykuarit e këtij procedimi penal, M. e F.M., janë gjetur fajtorë e dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. {***}, datë 30.03.2017, për veprën penale të “Mashtrimit”, të kryer në bashkëpunim e me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, e në bazë të kësaj dispozite e në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, janë dënuar respektivisht me 8 vjet e 6 vjet e 8 muaj burgim.

10.4 Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 18.10.2017, ka gjykuar çështjen mbi ankimin e të pandehurve, ka ndryshuar vendimin e mësipërm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe ka vendosur të deklarojë të pafajshëm të gjykuarin F.M., duke deklaruar fajtoje për veprën penale të “Mashtrimit” me pasoja të rënda, vetëm bashkëshorten e tij M.M., në bazë të nenit 143/3 i Kodit Penal, i ndryshuar tashmë në kohën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit, duke e dënuar atë në bazë të kësaj dispozite e në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale përfundimisht me 4 vjet burgim, i cili është urdhëruar të pezullohet për një periudhë prove prej 4 vitesh, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal.

10.5 Nga shqyrtimi i rrethanave të faktit në të cilat është zhvilluar kryerja e veprës penale sipas vendimeve të administruara, rezulton se ndaj të dy bashkëshortëve është ngritur akuza se kanë mashtruar duke përfutur shuma të konsiderueshme parash shtetasin maqedonas A.B., nëpërmjet blerjes fiktive të pronave të paluajtshme në emër e për llogari të tij, blerje të cilat në një pjesë të tyre kanë rezultuar se nuk janë kryer realisht, por janë përdorur akte të pavërteta për të mundësuar dërgimin prej këtij shtetasi në emër të të gjykuarës M.M., të shumave të përfuturara padrejtësisht. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke bërë një analizë të provave e të të dhënave të dala gjatë hetimeve paraprake të kësaj çështjeje në shkallë të parë, ka konkluduar se ky aktivitet i kundërligjshëm është kryer prej të dy bashkëshortëve M. në bashkëpunim dhe i ka deklaruar ata fajtorë për këtë formë të kryerjes së veprimtarisë kriminale. Në ndryshim nga ky konkluzion, trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Shkodër, kryesues i së cilës ka qenë subjekti i rivlerësimit, duke analizuar të gjitha provat e të dhënat e dala nga hetimi, ka arritur në një konkluzion të ndryshëm në lidhje me fajësinë e të gjykuarve, duke konkluduar se nuk ka pasur të dhëna të dala nga provat e administruara që të provonin tej çdo dyshimi rolin si bashkëpunëtor të bashkëshortit F.M. në kryerjen e aktivitetit kriminal të kryer prej të gjykuarës tjetër, M.M., për pasojë ka vendosur ta deklarojë atë të pafajshëm, duke pasqyruar në vendimin e saj të gjitha argumentet ligjore e duke prezantuar një analizë logjike të rrethanave të faktit që lidheshin me këtë konkluzion.

10.6 Në këndvështrim të këtyre rrethanave dhe konkluzioneve të arritura nga Komisioni në lidhje me këtë procedim, Kolegji çmon se qëndrimet e Komisionit në lidhje me këtë çështje mund të grupohen në dy grupe çështjesh, të cilat meritojnë një trajtim të ndryshëm në varësi të specifikave që ato paraqesin, duke tërhequr gjithashtu vëmendjen se kjo tipologji do të shfaqet edhe në trajtimin e çështjeve të tjera të kriterit të aftësive profesionale të cilat do të arsyetohen në vijim.

- I. Çështjet e para që shtrohen për zgjidhje, lidhen me qëndrime të Komisionit të cilat nuk dakordësohen me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Shkodër, sipas së cilës është deklaruar pafajësia e bashkëshortit F.M. dhe caktimi i masës së dënimit për të gjykuarën M.M.
- II. Grupi dytë i çështjeve lidhen me qëndrime të Komisionit të cilat kanë konsideruar si shkelje të subjektit të rivlerësimit, rolin pasiv të mbajtur prej gjykatës në lidhje me akuza të reja të cilat duhet të ishin ngritur në këtë çështje apo me zbatimin e gabuar të normave procedurale që determinojnë zhvillimin e një procesi korrekt sipas vlerësimit të Komisionit.

10.7 Në lidhje me çështjet e grupuara në grupin e parë, Kolegji konstaton se të gjitha vlerësimet e Komisionit lidhen dhe i adresohen zgjidhjes në themel të çështjes penale, duke tentuar të kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes nga ajo që ka kryer vetë Gjykata e Apelit në vendimin e saj. Në këto konkluzione të Komisionit, Kolegji verën se gjendemi para një tejkalimi të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Përpos pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se ky vlerësim i takon Gjykatës së Lartë, Kolegji çmon se kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, Kolegji çmon të nënvizojë parashikimin e nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: “Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”, dispozitë e cila thirret për zbatim, me referim në bazë të parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

10.8 Në këtë kuadër ligjor të zbatueshëm, Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njerit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij.

10.9 Përkrah këtij arsytimi, Kolegji konstaton se vendimi objekt vlerësimi nuk paraqet defekte në mënyrën se si ai është arsyetuar e argumentuar, por shoqërohet nga një vijë logjike dhe interpretative e arsyeshme mbi provat dhe përdorimin e aplikimin e harmonizuar të legjislacionit të brendshëm dhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke plotësuar në këtë mënyrë rekuizitat e nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa u përket elementeve që vlerësojnë njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor.

10.10 Në lidhje me grupin e dytë të konstatimeve të Komisionit, Kolegji vëren se ato janë të një natyre procedurale dhe, si të tilla, meritojnë vlerësimin e Kolegjit për sa u përket thelbit të tyre.

10.11 Në këtë kontekst, krahas pretendimeve të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit për të kundërshtuar qëndrimet e Komisionit, Kolegji konstaton se Komisioni ka konfunduar në qëndrimin e tij, detyrimet që në një proces penal i përkasin organit të prokurorisë me ato që i përkasin organit gjyqësor. Qëndrimi i Komisionit se subjekti, si pjesë e trupës gjyqësore që ka shqyrtuar çështjen, ka shfaqur mangësi në zbatimin e ligjit sepse nuk ka ngritur akuza të reja ndaj të gjykuarve që lidhen me akuzat për falsifikim aktesh apo me ngritjen e akuzave për një rreth më të gjerë personash të përfshirë me shumë mundësi në veprimtarinë kriminale të gjykuar, konsiderohet se është një qëndrim i gabuar dhe i pambështetur në dispozitat ligjore që normojnë dhe përcaktojnë rolin procedural të gjykatës në një proces penal. Nenet 372-377 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat janë konsideruar prej Komisionit se janë shkelur nga gjykata në çështjen në fjalë, nuk janë dispozita që ngarkojnë gjykatën me detyrimin të ngrëjë akuza të reja apo të shtrijë hetimet mbi persona të tjerë të cilët nuk janë përfshirë në akuzat e ngritura tashmë. Këto dispozita parashikojnë të drejtën dhe detyrimin e organit të akuzës që të reagojë ndaj rrethanave të reja që lidhen me faktin kriminal

e të cilat rezultojnë gjatë gjykimit nëpërmjet ngritjes së akuzave të reja dhe gjithashtu parashikojnë detyrimet e gjykatës për të respektuar e garantuar të drejtat e palëve në proces, kur këto akuza ngrihen eventualisht prej prokurorit të çështjes. Ndërkohë që neni 375 i Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtën e gjykatës si organ që jep drejtësi, të kualifikojë saktë faktin kriminal për të cilin është ngritur një akuzë, duke e përcaktuar atë ligjërisht saktë sipas vlerësimit të saj dhe analizës që ajo bën në përfundim të gjykimit të një çështjeje penale. Kjo kompetencë e gjykatës nuk mund të barazohet me të drejtën e prokurorit për të ngritur akuzë për një fakt të ri, e cila, në rast se ndodh, duhet t'u nënshtrohet të gjitha rregullave procedurale të cilat garantojnë të drejtat e liritë themelore të palëve në proces, në kuptim të zhvillimit të një procesi të rregullt, sipas parashikimit të nenit 6 të KEDNj-së e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

10.12 Një rol i ndryshëm i gjykatës në këtë drejtim është një parashikim ligjor i kryer me ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017¹⁴, sipas të cilit gjyqtari i seancës paraprake është ai që mund të ndërhyjë në ngritjen e akuzave para se çështja të dërgohet për gjykim, por edhe me këto ndryshime nuk gjendet asnjë parashikim i tillë për sa i takon gjykatës së themelit të çështjes, siç është rasti objekt shqyrtimi. Përpos këtij diskutimi, Kolegji vëren se edhe diskutimi mbi vetë akuzat të cilat Komisioni ka evidentuar se mund të ngriheshin në rastin konkret, siç është ajo e falsifikimit të dokumenteve, lidhen me diskutime të nivelit teorik e që përcaktojnë elementet e figurës së krimit të mashtrimit, e cila sipas doktrinës penale, kryhet në vetvete edhe me anë të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, duke e bërë këtë veprë të pakonkurrueshme me vetë veprën penale të mashtrimit në raste të tilla, diskutime të cilat meritojnë vlerësimin dhe analizën e organit që ngre akuzën dhe që, për më tepër, e përjashtojnë subjektin e rivlerësimit në rastin konkret nga kryerja e ndonjë parregullsie.

10.13 Përpos këtyre elementeve, Kolegji çmon se trupa gjyquese në të cilën ka qenë anëtar subjekti i rivlerësimit ka zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat penale që lidhen me aplikimin e ligjit penal favorizues sipas parashikimit të nenit 3, paragrafi 3 i Kodit Penal, për shkak të ndryshimeve që ka pësuar neni 143 nga koha e ndodhjes së veprës penale tek ajo e gjykimit në Gjykatën e Apelit, duke e kualifikuar faktin penal sipas parashikimit të nenit 143/3 të Kodit Penal të ndryshuar, vetëm në konsideratë të rrethanës cilësuese “të pasojës së rëndë” dhe duke aplikuar për pasojë masën e dënimit brenda marzheve të dënimit që parashikon kjo dispozitë.

10.14 Në të njëjtën linjë, Kolegji vlerëson edhe zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal të kryer nga gjykata në këtë rast, për sa kohë që në drejtim të verifikimit të kriterëve formale që parashikon kjo dispozitë, konstatohet se ato kanë ekzistuar në përputhje me këtë parashikim dhe me praktikën gjyqësore të gjithëpranuar rreth mënyrës së zbatimit të këtij parashikimi. Përtej këtij konstatimi, masa e dënimit të caktuar prej gjykatës apo verifikimi i rrethanave që lidhen me urdhërimin për pezullim të ekzekutimit të vendimit me burgim, konsiderohen prej Kolegjit si elemente që lidhen me vlerësimin e rrethanave të faktit, rrezikshmërinë e autorit të veprës, vlerësimin e rrethanave rënduese e lehtësuese apo çdo treguesi tjetër që i vlen gjykatës për të individualizuar dënimin e dhënë për një veprë penale brenda marzheve të dënimit që parashikon ligji, të cilat çmohet se janë elemente që lidhen me korrektësinë e themelshmërinë e mbështetur në bindjen e brendshme të këtij disponimi të gjykatës, e cila nuk mund të shërbejë si një faktor që afekton vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit në kuptim të këtij procesi, për të gjitha arsyet e argumentuara edhe më lart.

10.15 Në konkluzion të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se qëndrimi i Komisionit në lidhje me këtë çështje është i gabuar dhe nuk duhet të konsiderohet se afekton negativisht vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

¹⁴ Ligjin nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

11 Në lidhje me procedimin civil nr. {***}, të vitit 2013, që i përket shqyrtimet të ankimit mbi vendimin për rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë së paraqitur nga paditësja R.Q., subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se Komisioni ka gabuar në vlerësimin e tij dhe se as nuk ka referuar dispozitat ligjore të shkelura nga subjekti gjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë. Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, në lidhje me këtë çështje, ka rezultuar në mënyrë të përmbledhur se: [...] *Komisioni konstaton një mangësi profesionale, të konkretizuar në një vonesë shumë më përtej afatit të parashikuar, brenda të cilit subjekti duhej të kishte vendosur lidhur me rastin konkret. Po ashtu, mangësi vërehen edhe në lidhje me organizmin dhe planifikimin e punës – edhe në cilësinë e kryetarit të gjykatës – pasi organizimi dhe programimi i punës për shqyrtimin e dosjeve që lidhen me masa sigurie, nuk rezultojnë të jetë në përputhje me dispozitat procedurale që parashikojnë afate të ndryshme dhe shumë më të shkurtra për shqyrtimin e kërkesave për siguri padie.*

11.1 Në verifikim të rrethanave që lidhen e shqyrtimin e kësaj çështjeje, ka rezultuar se:

- i. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e saj nr. {***}, datë 03.12.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesës se paditësve R. e M.Q. për sigurimin e padisë me objekt “Goditje falsiteti të vendimit nr. {***}, datë 27.09.1996, të Komisionit të Kthimit të Pronave Shkodër”.
- ii. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, paditësit R. e M.Q., me anë të të cilit kanë kërkuar prishjen e vendimit nr. {***}, datë 03.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe pranimin e kërkesës për sigurim padie.
- iii. Me vendimin nr. {***}, datë 02.04.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është pushuar gjykimi i padisë së themelit të ngritur nga paditësit R. e M.Q., për shkak se paditësit kanë hequr dorë nga gjykimi i çështjes; vendim i cili ka marrë formë të prerë në datën 08.04.2013.
- iv. Me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2014, Gjykata e Apelit Shkodër, e cila ka pasur për objekt shqyrtimi ankimin ndaj vendimit nr. {***}, datë 03.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (i cili ka refuzuar vendosjen e sigurimit të padisë) është vendosur pushimi i shqyrtimit të kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit për shkak të pushimit të çështjes së themelit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, duke përdorur nenet 300 e 463 të Kodit të Procedurës Civile si bazë ligjore për këtë vendim.

11.2 Në vendimin e Komisionit, lidhur me këtë çështje, është arsyetuar se fakti që Gjykata e Apelit, në përbërje të së cilës ka qenë me rolin e relatorit dhe kryetarit të gjykatës subjekti i rivlerësimit, ka marrë për shqyrtim me vonesë prej gati 14 muajsh ankimin e paditësve R. e M.Q. ndaj vendimit që kishte rrëzuar kërkesën e tyre për masën e sigurimit të padisë, ndërkohë që vetë gjykimi i themelit të kësaj padie ishte zgjidhur një vit më parë, në prill të vitit 2013, evidenton në këtë mënyrë keqadministrim e keqorganizim të punës prej subjektit të rivlerësimit qoftë në cilësinë e relatorit të çështjes, qoftë në atë të kryetarit të gjykatës, përgjegjës për mbarëvajtjen e administrimit e institucionit.

11.3 Në lidhje me këto konstatime, Kolegji vlerëson *së pari* se nga analiza që u bëhet dispozitave ligjore në fuqi në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje, Kodi i Procedurës Civile para ndryshimeve që pësoi me ligjin nr. 38/2017, nuk ka pasur asnjë parashikim ligjor për trajtimin me prioritet apo në ndonjë modalitet të posaçëm lidhur me afatin apo formën e gjykimit, për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të ndërmjetme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, për të cilat ishte parashikuar ankim i veçantë sipas nenit 443/4 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo situatë për herë të parë pësoi rregullime të posaçme ligjore me ndryshimet që pësoi Kodi i Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017¹⁵, që në nenin 470 përcaktoi një afat kohor për shqyrtimin me prioritet të këtyre ankimeve.

¹⁵ Ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

11.4 Në këto kushte, duke pasur parasysh se ankimi i ushtruar ndaj një vendimi të gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, është i adresuar ndaj një vendimi të ndërmjetëm të gjykatës, pavarësisht faktit se ndaj këtij vendimi, sipas nenit 209 të Kodit të Procedurës Civile, nuk parashikohet të ushtrohet ankimi i veçantë, në drejtim të vlerësimit të aftësive organizative të subjektit për të cilat është konkluduar në vendimin e Komisionit, nuk gjendet ndonjë dispozitë ligjore apo rregull i brendshëm të cilin subjekti ta ketë shkelur me shqyrtimin e kësaj çështjeje në lidhje me kohën e shqyrtimit të saj, pas depozitimit të ankimit në Gjykatën e Apelit Shkodër.

11.5 Duke analizuar situatën edhe në drejtim të ndonjë shkeljeje të mundshme të të drejtave të palëve prej kësaj vonese, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Kolegji konstaton se për shkak të disa rrethanave të faktit, kjo situatë nuk rezulton të ketë ndodhur. Të tilla rrethana, në vlerësimin e Kolegjit, janë: i) ankimi i ushtruar nuk parashikohet se mund të ushtrohet si një ankimi i veçantë, por së bashku me vendimin përfundimtar, në këtë mënyrë në asnjë version pala nuk rezulton të jetë dëmtuar, sa kohë që një gjykatë apeli nuk ka pasur në lëndë të shqyrtojë një ankimi ndaj vendimit të themelit për çështjen; ii) vetë pala paditëse edhe denoncuese në procesin e rivlerësimit, R.Q., nuk rezulton se ka paraqitur ndonjë shqetësim që lidhet me ndonjë shkelje të ndonjë të drejte të saj përgjatë kohës që çështja qëndronte e varur në Gjykatën e Apelit për gjykim dhe as në seancën në të cilën kjo çështje është shqyrtuar, për pasojë, duke konsideruar përcaktimet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, gjendet i papranueshëm denoncimi i qytetares i ngritur vetëm dhe në funksion të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit; iii) vetë denoncuesja/paditëse në çështjen që i është nënshtruar shqyrtimit ka hequr dorë nga gjykimi i padisë së themelit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për pasojë të së cilës kjo gjykatë ka vendosur të pushojë gjykimin e çështjes, pa ngritur asnjë pretendim për këtë vendimmarrje nga paditësja; iv) në çdo rast, kur ligji nuk ka një parashikim të posaçëm për periudhën e shqyrtimit apo përparësitë për shqyrtimin e këtyre çështjeve, konsideruar dinamikën dhe ngarkesën e punës në gjykatat e apeleve me çështje të një natyre edhe më të ndjeshme e të rëndësishme për qytetarët, vonesa e marrjes në shqyrtim të këtij ankimi e humbet relevancën për trajtimin e saj si një mangësi e vlefshme për t'u evidentuar në drejtim të aftësive organizative të subjektit.

11.6 Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Kolegji konkludon se Komisioni ka gabuar kur ka konsideruar se subjekti gjendet në kushtet e mangësive në drejtim të aftësive organizative sipas parashikimit të nenit 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për shkak të marrjes për shqyrtim në një kohë jo të shpejtë të ankimit të përshkruar më lart dhe nuk e konsideron këtë gjetje si të vlefshme për të afektuar vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

¹² *Në lidhje me çështjen që u përket të gjykuarve F.Sh. e F.M., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi është marrë mbështetur në bindjen e brendshme, pas vlerësimit të situatës shkak-pasojë, megjithatë konstatimet e Komisionit lidhur me gjykimin e këtij procedimi penal nr. {***}, të vitit 2010, duhen vlerësuar me proporcionalitet dhe objektivitet pasi një rast i vetëm nuk mund të përbëjë shkak shkarkimi.*

12.1 Për këtë çështje, në vendimin e Komisionit, është konkluduar në mënyrë të përmblendhur se: [...] Komisioni vëren se në gjykimin e kryer nga Gjykata e Apelit Shkodër, në këtë çështje janë konstatuar këto mangësi profesionale: mungesë e vlerësimit të provave në harmoni me njëra-tjetrën dhe në mënyrë koherente; arsyetim i dobët mbi lidhjen shkak-pasojë. Bëhet fjalë për mangësi që bien ndesh me parimet dhe dispozitat ligjore, siç janë evidentuar dhe argumentuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur këtë vendim, duke lënë në fuqi atë të shkallës së parë.

12.2 Nga aktet e administruara gjatë hetimit, ka rezultuar se me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***}, datë 27.7.2009, është vendosur: *Deklarimi fajtor i të pandehurve F.Sh., F.M. e Gj.P. për kryerjen e veprës penale të "shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i*

*Kodit Penal e dënimit e tyre respektivisht me 6 muaj burg e 500.000 lekë gjobë. Gjithashtu gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një periudhë kohe prove prej 3 vjetësh, në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal. Ndaj këtij vendimi kanë ushtruar ankim të pandehurit dhe, mbi bazën e këtij ankimi, Gjykata e Apelit Shkodër, nëpërmjet trupit gjykues në të cilin ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit me cilësinë e anëtarit, me vendimin nr. {***}, datë 20.5.2010, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për sa ka disponuar për të pandehurin Gj.P.; prishjen e vendimit nr. {***}, datë 27.7.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në lidhje me të pandehurit F.Sh. dhe F.M., si dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të tyre, pasi nuk vërtetohet fajësia e tyre.**

Ndaj këtij vendimi të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 19.09.2012, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

12.3 Në mënyrë të përmbledhur, rezulton se procedimi penal i gjykuar me vendimet e mësipërme, është nisur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në vitin 2007, për shkak të konstatimit të dhënies së një leje ndërtimi prej Këshillit Bashkiak Shkodër, për miratimin e ndërtimit pothuaj të kryer në këtë kohë, të dy objekteve në truall ish-pronë private të ndodhur në qytetin e Shkodrës, në kundërshtim me kondicionet urbanistike dhe në shkelje të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën” i ndryshuar, duke cenuar në këtë mënyrë interesat e banorëve të godinave kufitare. Miratimi i këtyre lejeve është kryer nga Këshilli Bashkiak pas dakordësisë së dhënë prej zyrës së urbanistikës që funksiononte në Bashkinë Shkodër, në të cilën, në periudha të ndryshme kohore, kanë qenë drejtues të gjykuarit F.Sh. e F.M. Leja e ndërtimit është anuluar më pas prej Këshillit Bashkiak për shkak të ankesave të qytetarëve, të cilëve ndërtimet e reja u cenonin dritën dhe ajrosjen e banesave të tyre. Gjykata e Apelit, në trupin gjykues të së cilës ka qenë anëtar subjekti i rivlerësimit, në ndryshim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka deklaruar të pafajshëm dy të gjykuarit F.Sh. e F.M., duke arsyetuar se veprimet e tyre, ndonëse jo në përmbushje të rregullt të detyrës, nuk kanë qenë përcaktuese për ardhjen e pasojës, ndërtimin e objekteve të cilat ishin ndërtuar shumë kohë më parë, si një rrethanë fakti, në kushtet kur leja e miratuar dhe më pas e anuluar, konsistonte vetëm në miratimin e ndërtimeve të kryera ndërkohë. Ky arsyetim i Gjykatës së Apelit Shkodër është gjetur i padrejtë nga Gjykata e Lartë, e cila, pasi ka shqyrtuar çështjen mbi rekursin e paraqitur nga organi i akuzës, ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Apelit është i) *rrjedhë e një arsytimi jo të plotë për vlerën e pronave të administruara, si dhe në zbatim të gabuar të ligjit material; ii) në të kundërt të asaj që ka arsyetuar Gjykata e Apelit Shkodër, veprimet dhe mosveprimet e të gjykuarve kanë lidhje të drejtpërdrejtë me pasojën e ardhur, legjitimitimin e ndërtimeve të dy objekteve, të cilat janë bërë në shkelje të ligjit dhe kanë cenuar edhe të drejtat e pronarëve kufitarë në këto dy objekte*”. Në vijim të këtij arsytimi, Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Komisioni rezulton se ka mbështetur konkluzionet e tij për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, të marra në analizë në këtë çështje pikërisht mbi konkluzionet e përdorura në arsytimin e vendimit të Gjykatës së Lartë për vendimmarrjen e mësipërme.

12.4 Pasi shqyrtoi rrethanat e faktit, konstatimet e Komisionit dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë çështje, Kolegji vëren sërish se edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një vlerësim të kryer nga Komisioni mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes së marrë në shqyrtim. Nga natyra e çështjes dhe arsytimi i përdorur edhe në këndvështrim të pretendimeve e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, perceptohet qartë se evidentimi i problematikes që Komisioni ka konstatuar lidhet me gjykimin dhe vlerësimin nëse bindja e brendshme e krijuar prej trupës gjykuese mbi analizën e provave të marra gjatë procesit e në kuptim e zbatim të ligjit material, për

më tepër mbi një çështje tejet të debatueshme e profesionale, siç është analiza mbi ekzistencën e lidhjes shkakësore në kryerjen e një veprë penale, se nuk ekziston lidhja shkakësore mes veprimeve të parregullta të të gjykuarve dhe pasojës së ardhur, është një konkluzion i gabuar e ka ardhur si pasojë e një analize sipërfaqësore të të gjitha fakteve. Kolegji çmon se edhe në këtë rast gjendemi përpara së njëjtës situatë si ajo e përshkruar më lart në këtë vendim, paragrafët 10.7-10.8, kur Komisioni tejkalon kompetencën e tij kushtetuese e ligjore duke vlerësuar vendimmarrjen dhe zgjidhjen në themel të një çështjeje gjyqësore, atribut vetëm i një gjykate më të lartë. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se do të përdorej i njëjti arsyetim ligjor si ai i përdorur në arsyetimin më sipër, njësoj i vlefshëm dhe i zbatueshëm edhe për këtë qëndrim të Komisionit.

12.5 Gjithashtu, Kolegji vlerëson të nënvizojë qëndrimin se fakti që një gjykatë më e lartë, në këtë rast Gjykata e Lartë e vendit, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në vlerësimin e një çështjeje gjyqësore nga ajo që ka mbajtur gjykata ku është pjesë e vendimmarrjes magjistrati (subjekti i rivlerësimit), nuk mund të përdorej apriori si një argument për të vlerësuar negativisht aftësitë profesionale të magjistratit, veçanërisht ato që lidhen me zgjidhjen e çështjes, siç është rasti konkret. Në këtë arsyetim, vlen të silllet në vëmendje se edhe sistemi i vlerësimit periodik të magjistratëve, i parashikuar prej ligjit nr. 96/2016, nuk parashikon matjen e aftësive për gjykim apo arsyetimin ligjor të magjistratëve në varësi të qëndrimit që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet e tyre. Aq më shumë, ky kriter nuk mund të përdoret si determinant në procesin e rivlerësimit, në të cilin pasoja e vlerësimit profesional mund të ndikojë në mënyrë thelbësore fatin profesional të magjistratit, por edhe më tepër kur i gjithë ky proces ka pasur nën vlerësimin e tij edhe vetë aftësitë profesionale të të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, të cilët në raste të caktuara, në varësi të shkallës ku kanë gjykuar, mund të kenë qenë përkatësisht, gjyqtarë më të lartë ose më të ulët. Në këtë kontekst, qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta mund të provokojnë një vlerësim apo hetim të mëtejshëm drejt sjelljes profesionale të magjistratit, por ato nuk mund të jenë kriteri matës determinant për vlerësimin e aftësive profesionale të tyre. Përpos këtij arsyetimi, rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Lartë në Shqipëri, dhe parimet e gjithëpranuara të Bangalores mbi sjelljen e gjyqësorit, kanë qenë të qarta dhe eksplicite në këto raste për mospërdorimin e një vendimi të një gjykate më të lartë për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët¹⁶.

12.6 Në konkluzion të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se konstatimet e Komisionit në lidhje me këtë çështje gjyqësore, nuk mund të përdoren për të vlerësuar njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor, në kuptim të nenit 72/2 të ligjit nr. 96/2016, si një nënindikator për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

¹⁶ Në rekomandimin e Këshillit të Evropës, përkatësisht të Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare [17 nëntor 2010 CM/Rec(2010)12], “Mbi pavarësinë e efikasitetit dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve”, në Kreun VII ku trajtohet përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, përcaktohet se: “Interpretimi i ligjit, vlerësimi i fakteve ose i provave të kryera nga gjyqtarët gjatë gjyqësimit të çështjeve nuk duhet të shkaktojë përgjegjësi civile ose disiplinore, përveç në rastet e keqdashjes dhe neglizhencës së rëndë. [...] Gjyqtarët nuk mund të jenë personalisht përgjegjës në rastet kur vendimet e tyre ndryshohen nga një gjykatë më e lartë. [...]”

- Shih “Komentarin mbi parimet e Bangalores mbi etikën e gjyqtarëve” (sekreti profesional dhe imuniteti i gjyqtarëve): https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf

- Shih vendimin nr. 26, datë 23.05.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, paragrafi 22.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e gjen me vend konkluzionin e arritur nga Prokuroria e Përgjithshme në vendimin objekt shqyrtimi kur konkludon se: “fakti që ata (gjyqtarët e Gj. Kushtetuese) kanë vendosur të rrëzojnë kërkesën e paraqitur nga kallëzuesi nuk përbën shkak në vetvete për të ushtruar ndjekjen penale ndaj tyre për shpërdorim detyrë. Gjithashtu në kallëzim nuk konstatohen as elemente të ndonjë veprë tjetër penale të parashikuar në Kodin Penal”.

13 Në lidhje me çështjen penale që u përket të gjykuarve G. e V.H., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se qëndrimet e mbajtura nga Komisioni për denoncimin e shtetasit/avokatit R.L., që kanë të bëjnë me çështjen penale nr. {***} të vitit 2007, janë të pabazuara, të ndryshme me standardin e mbajtur nga Komisioni në raste të tjera të ngjashme dhe në tejkalim të ligjit, pasi për këtë procedim ka edhe një vendimmarrje nga Gjykata e Lartë e cila nuk ka ndryshuar vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Shkodër.

13.1 Nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit në lidhje me këtë çështje, rezulton se në mënyrë të përmbledhur është arritur në përfundimin se: [...] Ka pasur mangësi profesionale lidhur me procedurën e ndjekur, si dhe me mënyrën e marrjes së provave, pasi Gjykata e Apelit Shkodër, pasi ka dëgjuar dëshmitarin/viktimën (shtetasin A.K.), nuk e ka marrë për bazë provën e krijuar përpara trupit gjykues pa e argumentuar përse e kreu këtë dëgjese, nëse ajo nuk ishte e rëndësishme, apo nëse mjaftonte çfarë kishte pohuar më herët i njëjti shtetas.

Kjo rrethanë mbart një rëndësi të veçantë, nga momenti që deklarimi i dhënë nga shtetasi A.K. përpara OPGJ-së rezulton të jetë e vetmja provë – në bazë të së cilës është dënua G.H. me 21 vjet burg – e cila nuk rezulton të jetë marrë, sipas parashikimeve të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale dhe pa pasur garancinë e dokumentuar/certifikuar nga autoritetet shëndetësore që shtetasi A.K. gëzonte aftësi të plota psiko-fizike, fakt ky i domosdoshëm, duke pasur parasysh vendin, rrethanat, mënyrën dhe kohën në të cilat është marrë kjo dëshmi, duke u konstatuar një gjykim i dobët nga subjekti.

Duket se marrja dhe përdorimi i provës në fjalë është kryer në kundërshtim me nenet 321, 322 dhe 362 të Kodit të Procedurës Penale, në bazë të të cilave prova duhet të formohet përpara trupit gjykues, dhe rastet përjashtimore janë të parashikuara në mënyrë taksative dhe ato duhet të argumentohen dhe motivohen – gjë nuk rezulton që të jetë bërë nga subjekti.

13.2 Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, rezulton se procedimi penal në fjalë është regjistruar si i tillë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me nr. {***}, datë 08.07.2001, në ngarkim të shtetasve G.H. e V.H., të akuzuar se kanë kryer veprën penale të “vrasjes me paramendim” në bashkëpunim, e të mbetur në tentativë në dëm të shtetasit A.K., të parashikuar nga nenet 78/2, 25 e 22 të Kodit Penal, si edhe veprën penale të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake e municioneve”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila me vendimin nr. {***}, datë 08.01.2007, ka vendosur deklarin fajtor të të gjykuarve për akuzat e ngritura dhe dënimin e tyre përfundimisht me 21 vjet e 23 vjet burgim. Ky vendim është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, në përbërje të së cilës ka qenë edhe subjekti rivlerësimit, mbi ankimin e të pandehurve, e cila pasi ka vendosur përsëritjen e pjeshme të shqyrtimit gjyqësor dhe pyetjen e disa dëshmitarëve, përfshi edhe viktimën, ka vendosur në përfundim të gjykimit me vendimin nr. {***}, datë 17.01.2008, lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit.

13.3 Kolegji mori në shqyrtim konkluzionet e Komisionit për këtë çështje nën dritën e pretendimeve të ngritura në ankim prej subjektit të rivlerësimit dhe çmon se këto konkluzione lidhen me zbatimin e disa dispozitave procedurale në gjykimin e kësaj çështjeje, të cilat sipas vlerësimit të Komisionit janë zbatuar gabim prej trupës gjykuese në të cilën ka bërë pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, për pasojë Kolegji vlerëson se analizimi i tyre përfshihet brenda kompetencës së organeve të rivlerësimit për të matur indikatorin e njohurive ligjore të subjektit sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, në funksion të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit.

13.4 Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, ka rezultuar se trupi gjykues, i cili ka gjykuar çështjen e mësipërme në Gjykatën e Apelit, ka vendosur mbi kërkesën e mbrojtjes së të pandehurve, të riçelë

pjesërisht shqyrtimin gjyqësor të çështjes dhe të thërrasë e të pyesë me cilësinë e dëshmitarit të dëmtuarin A.K. dhe vëllain e tij, të cilët nuk ishin pyetur si të tillë përgjatë gjykimit në shkallë të parë. Gjatë pyetjes në gjykim, i dëmtuari, ndryshe nga sa ishte shprehur në procesverbalin e pyetjes me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e ngjarjes nga oficeri i policisë gjyqësore, menjëherë sapo kishte ndodhur ngjarja, ka mohuar të ketë identifikuar të akuzuarit si autorë të goditjes së tij me armë zjarri, duke thënë se autorët ishin me maska e nuk ka mundur t'i identifikojë dot ata. Në ndryshim nga këto deklaramime, i dëmtuari kishte identifikuar të akuzuarit si autorë të ngjarjes në pyetjen e tij të menjëhershme pas ndodhjes së ngjarjes. Një dëshmi të ngjashme ka dhënë në gjykim edhe vëllai i të dëmtuarit, duke referuar te vetë i dëmtuari si burim i informacionit. Pavarësisht këtyre deklaramimeve të dhëna me cilësinë e dëshmitarit, përafërsisht 7 vjet pasi kishte ndodhur ngjarja (në vitin 2001), gjykata ka pranuar si të vërteta deklaramimet që i dëmtuari ka dhënë në momentin e parë para oficerit të policisë gjyqësore, duke deklaruar fajësinë e të akuzuarve për ngjarjen dhe duke lënë në fuqi vendimin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Për shkak të kësaj situatë, Komisioni ka ngritur çështje që lidhen me zbatimin e neneve 320-321 e 322 e 362 të Kodit të Procedurës Penale duke arsyetuar se sjellja e gjykatës, e mbështetur vetëm në një provë për deklarimin fajtor të marrë jo gjatë procesit gjyqësor, vjen në kundërshtim me këto dispozita dhe duke e konsideruar këtë vendimmarrje si një mangësi të subjektit të rivlerësimit në njohuritë e tij mbi ligjin.

13.5 Në lidhje me këtë qëndrim, Kolegji konstaton *së pari* se përmendja dhe konkluzioni se janë shkelur nenet 321 e 322 të Kodit të Procedurës Penale, në marrjen e kësaj prove, konsiderohen jorelevante në trajtimin e situatës së mësipërme. Këto dispozita të cilat rregullojnë institutin e sigurimit të provës, nuk mund të shtrohen për analizë në rastin konkret, për sa kohë që çështja gjendet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit. Nëse Komisioni ka dashur të potencojë faktin se këto dispozita janë një nga mënyrat e marrjes së provës para gjykatës, dhe ky institut nuk është zbatuar për të marrë dëshminë e të dëmtuarit në kohën që ka ndodhur ngjarja, sipas vlerësimit të Kolegjit, ky element nuk mund të ngrihet në nivelin e një gjetjeje që mund t'i adresohet subjektit të rivlerësimit, i cili nuk ka qenë në kohën e ndodhjes së ngjarjes as prokurori i çështjes dhe as gjyqtari i hetimeve paraprake. Fakti që organi i akuzës apo mbrojtja nuk kanë zgjedhur të zbatojnë institutin e sigurimit të provës që në hetime paraprake dhe të merrnin dëshminë e të dëmtuarit që në atë fazë, është një zgjedhje për të cilën nuk mund të qortohet subjekti dhe as trupa gjyqësore që shqyrton çështjen në apel.

Konkluzioni tjetër se përse Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur të riçelë hetimin për të pyetur dëshmitarët, të cilat më pas nuk i ka vlerësuar se kanë dhënë informacione të vlefshme për çështjen, është përsëri një konkluzion i padrejtë në rrethanat që është gjendur çështja, për sa kohë që rezulton se ata nuk ishin pyetur asnjëherë para gjykatës dhe mbrojtja ka pretenduar pyetjen e tyre të drejtpërdrejtë nga një gjykatë. Në këto kushte, duket se vlerësimi i trupit gjyqësor të Gjykatës së Apelit për të pyetur dëshmitarët ka qenë një vendim në funksion të garantimit të së drejtës së të gjykuarve për të pasur një proces mbi zbatimin e parimit të kontradiktoritetit. Sigurisht që pyetja e tyre dhe vlerësimi i dëshmisë mbetet një atribut i trupës gjyqësore që gjykon çështjen në raport me të gjitha të dhënat e tjera të mbledhura gjatë procesit.

13.6 Për sa i përket konkluzionit tjetër të mbajtur prej Komisionit se trupa gjyqësore në të cilën ka qenë pjesë subjekti i rivlerësimit, duke njohur me vlerë provuese deklaramimet e bëra nga i dëmtuari

para oficerit të policisë gjyqësore, ka marrë vendim në kundërshtim me nenin 362 të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji ndan gjithashtu një qëndrim të ndryshëm. Neni 362 i Kodit të Procedurës Penale është dispozita që rregullon përdorimin në një proces gjyqësor të deklarimeve të bëra nga personat që kanë dijeni për rrethanat e ngjarjes gjatë fazës së hetimit paraprak, me qëllim kundërshtimin e dëshmisë që ata bëjnë gjatë procesit gjyqësor dhe përcaktimit të vlerës provuese të tyre¹⁷. Në çështjen objekt analize, ka rezultuar se personi i dëmtuar është thirrur të dëshmojë në gjykimin në apel, me kërkesë të mbrojtjes së të pandehurve, pas 7 vitesh pasi kishte ndodhur ngjarja. Në këtë gjykim, rezulton se i dëmtuari ka dhënë deklarime që shfaqësonin të akuzuarit për tentativën e vrasjes së kryer ndaj tij dhe të cilat binin në kundërshtim me atë që ai kishte deklaruar në momentet e para pas ndodhjes së ngjarjes.

13.7 Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata me të drejtë ka njohur si me vlerë provuese deklaratimet e para të tij, duke ndjekur në këtë mënyrë zbatimin e rregullit të parashikuar nga neni 362/4 i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon situatën kur këto deklarime çmohen si prova kur rezultojnë rrethana që kanë dëmtuar sinqeritetin e dëshmitarit. Rasti objekt gjykimi duket nga analiza e fakteve se përfaqëson pikërisht situatën në të cilën duhet të gjejë zbatim ky parashikim ligjor, duke qenë se sipas dëshmive rezulton se ngjarja për të cilën akuzohen të gjykuarit është vazhde e një seriali vrasjesh e plagosjesh mes familjes së të dëmtuarit dhe të akuzuarve. Për këtë histori gjakmarrjeje/hakmarrjeje flasin jo vetëm familjarët e të dëmtuarit, por edhe vetë babai i të gjykuarve i cili përcakton në deklaratimet e tij si motivin e tentativës për vrasje, dhe autorët e saj duke identifikuar vetë djemtë e tij për këtë ngjarje kriminale. Në të njëjtën linjë, kanë qenë në deklaratimet e para edhe në gjykimin në shkallë të parë edhe familjarët e të dëmtuarit, bashkëshortja dhe motra e tij, të cilët, duke iu referuar vetë të dëmtuarit si burim, adresojnë veprimtarinë kriminale pikërisht të të akuzuarit në këtë gjykim. Në të njëjtën linjë më këto deklaratime ka qenë edhe vetë deklarimi që i dëmtuari ka dhënë para oficerit të policisë gjyqësore, në një rrëfim origjinar e të papërpunuar, për shkak të kohës së shkurtër prej ndodhjes së ngjarjes. Të gjitha këto elemente janë konsideruar me të drejtë prej gjykatës, kur ka vlerësuar sipas parashikimit të nenit 362/4, se për shkak të disa rrethanave të tjera, sinqeriteti i dëshmisë së të dëmtuarit në gjykim është kompromentuar dhe, si e tillë, kjo dëshmi nuk mund të përdoret me cilësinë e provës. Në këtë kontekst, Kolegji mban parasysh faktin se dëshmia e dhënë pas shumë vitesh, e thirrur me kërkesë të mbrojtjes, natyrshëm të bën të mendosh se duhet të perceptohet si një akt në favor të saj dhe duke konsideruar edhe fenomenin e gjakmarrjes, i cili në zonën e Shkodrës ka dominuar ngjarjet kriminale prej vitesh duke prodhuar jo vetëm ngjarje tragjike për viktimat, por edhe drama të rëndësishme sociale për të gjithë familjarët e përfshirë në të, duket se e ka çuar të dëmtuarin të deformojë dëshminë e tij, ose me qëllim të qetësimit të gjakrave, ose në funksion të zbatimit të

¹⁷ Neni 362 i Kodit të Procedurës Penale. “1. Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmisë ose kur refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, por vetëm pasi dëshmitari ka deponuar mbi faktet dhe rrethanat që kundërshtohen. 2. Këto thënie nuk përbëjnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por ato mund të vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur dhe përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor. 3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. 4. Deklarimet e mëparshme, të përfshira në fashikullin e gjykimin, sipas pikës 2 të këtij neni, çmohen si prova edhe kur rezulton se dëshmitari qoftë edhe gjatë pyetjes në seancë i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t’i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme, si dhe kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë dëmtuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij”.

riteve kanunore prej tij apo familjarëve të tij. Në këto rrethana, me të drejtë Gjykata e Apelit ka vlerësuar si të pabesueshme dëshminë e bërë në gjykim dhe u ka dhënë vlerë provuese sipas dispozitës së mësipërme, deklarimeve të kryera para oficerit të policisë gjyqësore.

13.8 Kolegji konstaton gjithashtu se është i gabuar edhe konkluzioni i Komisionit se dënimi i të gjykuarve është mbështetur vetëm në një provë të vetme dhe ajo e paformuar gjatë gjykimit, duke qenë se deklaratimet e bëra nga i dëmtuari para oficerit të policisë gjyqësore, të cilat janë çmuar si provë nga gjykata, janë mbështetur nga disa prova të tjera në proces, siç janë deklaratimet e përmendura më lart prej familjarëve të të dëmtuarit, por edhe babait të autorëve, si edhe sidomos nga një seri ngjarjesh kriminale të ndodhura që i kanë paraprirë e kanë shërbyer si motiv për kryerjen e kësaj vepre penale. I gjithë ky proces rezulton të jetë kryer prej trupës gjyqësore në zbatim të nenit 152¹⁸ të Kodit të Procedurës Penale duke dhënë një vendim të bazuar në prova e bindjen e brendshme.

13.9 Në konkluzion të sa më sipër, Kolegji çmon se qëndrimet e Komisionit në lidhje me këtë çështje nuk janë të drejta dhe se në gjetjet e tij nuk gjenden elemente të mangësive në njohuritë e ligjit për subjektin e rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për pasojë këto qëndrime nuk mund të konsiderohen prej Kolegjit si mangësi që mund të afektojnë vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit në kuadër të këtij procesi.

14 *Në lidhje me çështjen që i përket denoncimit të shtetasit A.Gj. për procedimin civil nr. {***} të vitit 2018, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit duke pretenduar se ai ka nuk ka shkelur etikën, pasi nuk ka komunikuar me palën jashtë seancës gjyqësore dhe se prova e re e marrë prej gjykatës, është marrë në bazë të së drejtës së saj për të marrë një provë kryesisht, gjithashtu subjekti ka pretenduar se përderisa kjo çështje është për gjykim në Gjykatën e Lartë, ajo nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni.*

14.1 Nga verifikimi i vendimit të Komisionit në lidhje me këtë çështje, rezulton se në mënyrë të përmbledhur, ai ka konkluduar se: [...] Komisioni vlerëson se subjekti, në këtë rast, ka kryer shkelje procedurale duke evidentuar mangësi të rënda dhe të shumëfishta profesionale, që lidhen: me mënyrën e marrjes së provave në kundërshtim me nenin 465 të Kodit të Procedurës Civile, përtej kompetencës; me administrimin dhe përdorimin e një prove që nuk kishte lidhje me objektin e çështjes që po shqyrtohej; me gjykim të dobët, argumentim dhe mbështetje të vendimit mbi një provë që është jashtë objektit të gjykimit; me dhënie sugjerimesh/këshillash apo kërkesa nga gjyqtari (jashtë seancës gjyqësore formale, me mikrofon të fikur), në favor të njërit palë dhe në dëm të tjetrit, gjatë dhe në lidhje me një proces gjyqësor që ai gjykon; me etikën dhe mosrespektimin e pikës 4 të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, për dorëheqjen e gjyqtarit, në vijim të faktit të sipërcituar; me shkelje të të drejtave të njërit palë në favor të palës tjetër. Gjithashtu, Komisioni çmon se këto shkelje lidhen me

¹⁸ Neni 152 i Kodit të Procedurës Penale, i titulluar “Çmuarja e provave”, në fuqi në vitin 2008 kur Gjykata e Apelit Shkodër ka dhënë vendimin, parashikonte:

“1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi.

2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.

3. Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.

procedurat e gabuara dhe joetike të ndjekura përgjatë një procesi gjyqësor dhe kanë cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

14.2 Në lidhje me këtë çështje, nga shqyrtimi i fakteve të dala gjatë hetimit administrativ¹⁹, ka rezultuar se kjo çështje gjyqësore lidhet me një konflikt pune mes denoncuesit A.Gj. si punëmarrës e Bashkisë Lezhë si punëdhënëse. Pas një konflikti mes denoncuesit e një punonjësi tjetër në Bashkinë Lezhë dhe një urdhri për pezullim nga detyra të dhënë ndaj denoncuesit prej kryetarit të Bashkisë Lezhë dhe një situatë pezullimi për sa i përket ushtrimit të funksioneve, marrëdhënia e punës mes këtyre palëve është zgjidhur për shkak të ndërhyrjes së Komisionit të Shërbimit Civil, i cili e ka gjetur atë të lidhur në kundërshtim me ligjin nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe ka urdhëruar konstatimin e pavlefshmërisë së emërimit. Palët ndërgjyqëse rezultojnë se kanë zhvilluar një gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, në të cilin është kontestuar gjyqësisht prej punëmarrësit A.Gj. urdhri i pezullimit të tij nga detyra, proces i cili ka rezultuar të përfundojë më rrëzimin e padisë. Procesi gjyqësor për kundërshtimin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës dhe riparimin e pasojave të ardhura prej saj, është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila ka pranuar plotësisht padinë e paditësit A.Gj., duke urdhëruar palën e paditur Bashkia Lezhë të dëmshpërblejë paditësin më shumë e pretenduara prej tij, në zbatim të parashikimeve të Kodit të Punës. Në këtë proces gjyqësor, pala e paditur ka tentuar të kërkojë administrimin e vendimit nr. 651, datë 06.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, që ka vendosur për rrëzimin e kërkesëpadisë së A.Gj. për shfuqizimin e urdhrit të pezullimit, i cili ishte marrë vetëm pak kohë më parë gjykimit të kësaj çështjeje, por pa paraqitur në rrugë procedurale një kërkesë për këtë qëllim. Në këto kushte, ky gjykim është zhvilluar pa u shqyrtuar ajo provë, megjithëse pala e paditur ka pretenduar e mbështetur prapësimet e saj në pjesën dërrmuese të tyre pikërisht mbi argumentin se gjykata administrative kishte gjetur të drejtë pezullimin nga detyra të paditësit për shkak të sjelljes së tij joetike ndaj një kolegu. Në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit Shkodër, pala e paditur ka kërkuar që të administrohet kjo provë, vendimi nr. {***}, datë 06.10.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, por gjykata e ka refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin që pala nuk mund të paraqiste kërkesë për prova të reja në apel, dhe njëkohësisht ka vendosur kryesisht të riçelë hetimin gjyqësor dhe të marrë kryesisht këtë provë të pretenduar nga pala e paditur. Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 20.03.2019, nga deklarimi i përfaqësuesit të palës së paditur, duket se kjo palë ka paraqitur provën e sugjeruar për këtë veprim nga kryesuesi i trupës gjyqësore, që ka qenë subjekti i rivlerësimit²⁰. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur të ndryshojë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe të rrëzojë padinë e paditësit duke arsyetuar se zgjidhja e marrëdhënies së punës ka qenë në kushtet e zgjidhjes së menjëhershme e të justifikuar.

¹⁹ Për këtë çështje, hetimi i Komisionit është iniciuar nga denoncimi i palës ndërgjyqëse A.Gj.

²⁰ Në procesverbalin e seancës gjyqësore në gjykimin në apel të datës 20.03.2019, pas kërkesës së përfaqësueses së palës së paditur, Bashkia Lezhë, e cila shpreh se ka kërkesë për riçeljen e shqyrtimit për të marrë prova dhe qëndrimin të avokates së palës paditëse, A.Gj., se absolutisht nuk duhet pranuar kërkesa për riçeljen e hetimit pasi pala e paditur ka pasur kohë të mjaftueshme për ta paraqitur duke u shprehur se ai vendim ka qenë shumë lehtë i siguroshëm dhe nuk mund të pranohet një kërkesë, aq më tepër që nuk është kërkuar paraprakisht, trupi gjyqësor shpreh se:

“Pasi u këshillua, vendosi të rrëzojë kërkesën e palës së paditur për të riçelur shqyrtimin gjyqësor për të marrë si provë vendimin nr. {***}, datë 06.10.2017, pasi e gjen të drejtë pretendimin e avokates që kjo provë duhet të ishte paraqitur me kohë. Megjithatë vendos kryesisht të riçelë hetimin gjyqësor dhe ta marrë këtë provë, duke e çmuar të domosdoshme për këtë gjykim, kjo provë nuk mund të anashkalohet pa u marrë në shqyrtim”.

14.3 Nga analiza që u bëhet këtyre rrethanave të faktit, në dritën e parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar, dispozitave që kanë qenë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit, konstatohet se sjellja e trupës gjyquese me vendimin për të riçelur kryesisht hetimin gjyqësor e marrjen e një prove e cila nuk ishte paraqitur prej palës në momentin e duhur kohor dhe as ishte pretenduar se gjendej në ato rrethana të veçanta të parashikuara prej nenit 186 të Kodit të Procedurës Civile²¹, është në tejkalim të rolit të gjykatës në një proces civil nën dritën e ndryshimeve të reja që ka pësuar procedura civile.

14.4 Parashikimi i nenit 465/3 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: “Me kërkesë të palëve ose kryesisht, gjykata e apelit riçel pjesërisht ose tërësisht hetimin gjyqësor”, i përdorur si argument prej subjektit për të justifikuar vendimmarrjen e trupës gjyquese, nuk shihet si relevant prej Kolegjit, sepse me të vërtetë që dispozita parashikon të drejtën e Gjykatës së Apelit të riçelë kryesisht hetimin gjyqësor, por kjo dispozitë ka ndryshuar thelbësisht për sa i përket të drejtës së gjykatës për të marrë prova të reja sipas parashikimit që kishte kjo dispozitë para ndryshimeve²² dhe në të njëjtën frymë janë të gjitha ndryshimet që ka pësuar ky kod duke e pozicionuar gjykatën në një rol krejt pasiv dhe të baraslarguar prej palëve në një proces civil. Në këto raste, kur gjykata do të vendosë kryesisht riçeljen e hetimit gjyqësor, ajo do të ketë të drejtën të rimarrë prova të marra nga gjykata e shkallës së parë nën nevojën e sqarimit të situatës faktike apo shqyrtimit të drejtpërdrejtë të ndonjë prove. Për shkak të këtyre ndryshimeve, Kolegji verën se me të drejtë Komisioni në këtë rast ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në tejkalim të kompetencave e rolit të një gjykate në një proces civil duke performuar një rol aktiv që, sipas ndryshimeve të reja procedurale, nuk e gëzon më.

14.5 Për sa i përket, konkluzionit se subjekti i rivlerësimit ka sugjeruar paraqitjen e kësaj prove, fakt që deduktohet nga mënyra se si është shprehur përfaqësuesi i palës së paditur në procesverbalin e seancës gjyqësore, Kolegji e gjen jobindës këtë konkluzion në raport me rolin dhe sugjerimin e subjektit për sa kohë që në atë akt pasqyrohet vetëm deklarimi i përfaqësuesit të palës së paditur, por jo deklarimet e vetë subjektit të rivlerësimit. Në këto rrethana, nuk mund të konsiderohet e provuar ajo çfarë ka pretenduar denoncuesi dhe as të ketë një informacion mbi rrethanat në të cilat është kryer orientimi sipas pretendimit të tij.

14.6 Kolegji gjithashtu ndan qëndrim të ndryshëm me konkluzionin e Komisionit se marrja e vendimit nr. {***}, datë 06.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka qenë një provë e panevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe se subjekti ka treguar mangësi profesionale në kërkimin e kësaj prove. Sipas vlerësimit të Kolegjit, vendimi i mësipërm ka pasur peshën e tij për zgjidhjen e çështjes, për sa kohë që paditësi ka pretenduar se marrëdhënia e punës është zgjidhur pa shkaqe duke e dëmtuar padrejtësisht atë, dhe vendimi ka përcaktuar pikërisht rolin

²¹ Neni 186 (ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017): “1. Pas urdhrat të gjyqtarit të vetëm për caktimin e seancës gjyqësore, sipas nenit 158/c të këtij Kodi, nuk mund të kërkohen prova të reja dhe të pretendohen fakte të reja, përveçse kur: a) pala e interesuar provon se, pa fajin e saj, nuk ishte në gjendje të paraqiste këto fakte dhe/ose prova të reja më parë; b) pala e interesuar provon se nuk mund të ishte në dijeni të fakteve dhe/ose provave të reja; c) ekziston një interes publik për pranimin e provave të reja”.

²² Neni 465 parashikonte se: “Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë, të parashikuara në këtë Kod. Me kërkesën e palëve ose edhe kryesisht gjykata e apelit përsërit tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor. Në shqyrtimin gjyqësor mund të lexohen aktet e gjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka të drejtë të marrë edhe prova të reja”.

e paditësit në zgjidhjen e kontratës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës që në fakt kishte si prelude pezullimin e tij nga detyra.

14.7 Kolegji gjithashtu çmon të padrejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo çështje, duke qenë se gjendet e rekursuar në Gjykatën e Lartë, nuk mund të jetë objekt shqyrtimi e analizimi nga organet e rivlerësimit. Në një qëndrim të konsoliduar tashmë ²³, Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] *Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj, dhe qenia e saj e varur para Gjykatës së Lartë, në pritje të një gjykimi atje, nuk e bën këtë çështje “nën shqyrtim”, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, për pasojë Komisioni ka qenë i legjitimuar të analizojë e vlerësojë edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

14.8 Në konkluzion të këtij arsytimi, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit në lidhje me këtë çështje është i drejtë për sa i përket konstatimit se subjekti ka vepruar në kundërshtim me parashikimet e nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, duke marrë një prove të re kryesisht, duke e konsideruar këtë mangësi si një mangësi në drejtim të njohurive ligjore sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, mangësi e cila do të konsiderohet prej Kolegjit në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të aftësisë profesionale të subjektit në kuadër të këtij procesi.

15. *Në lidhje me çështjen penale që i përket procedimit penal nr. {***}, të vitit 2011, në ngarkim të të gjykuarve S.M., B.K. e E.K., të akuzuar se kanë kryer veprën penale të vrasjes së të miturit A.L. dhe qëndrimin të mbajtur prej Komisionit në lidhje me të, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se analiza e kësaj çështjeje nën petkun e “faktit të njohur botërisht” vetëm pas riçeljes së hetimit gjyqësor, është një keqdashje e tregues njëanshmërie i trupës gjyqësore në Komision dhe se, përveç pranimit të kualifikimit të gabuar për veprën penale të sigurimit të kushteve për vrasje ndaj të gjykuarit S.M., vendimmarrja në pjesën tjetër të saj në këtë çështje ka qenë konform bindjes së brendshme të gjyqtarit dhe, për më tepër, është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë.*

15.1 Në lidhje me këtë çështje, në verifikim të vendimit të Komisionit, Kolegji konstaton se analizimi dhe shqyrtimi i saj është bërë prej Komisionit vetëm pas riçeljes së hetimit pas denoncimit të shtetasit R.L., me cilësinë e avokatit në çështjen e të gjykuarve G. e V.H., të trajtuar më lart në këtë vendim, dhe pa pasur ndonjë input apo informacion specifik që lidhej me këtë procedim. Komisioni ka vlerësuar të trajtojë këtë rast nën cilësimin e tij si “një fakt i njohur botërisht” dhe pasi e ka analizuar atë ka konkluduar në mënyrë të përmbledhur se: *Komisioni çmon se faktet e mësipërme, si dhe konstatimet e Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë, si më lart, evidentojnë disa mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe vetë – në shpjegimet e tij – e ka pranuar se riformulimi i cilësimit të veprës penale ka qenë i gabuar (edhe pse me efekt penalizues dhe jo favorizues ndaj të pandehurit). Gjithashtu, nga konstatimet e Inspektoratit të*

²³ Shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019; nr. 16/2020 (JR), datë 13.07.2020.

Ministrisë së Drejtësisë rezulton se subjekti ka shkelur rregullën nr. 8 të Kodit të Etikës Gjyqësore; nenin 4 të vendimit nr. 238/1/b, të datës 24.12.2008, të KLD-së; pikat 1 dhe 2 të nenit 152 dhe nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale. Së fundmi, këto shkelje lidhen me procedurat e gabuara dhe joetike të ndjekura përgjatë një procesi gjyqësor dhe kanë cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

15.2 Nga analiza që u bëhet fakteve që kanë rezultuar prej hetimit administrativ në lidhje me këtë çështje, Kolegji konstaton *së pari* se kualifikimi i kësaj çështjeje si një fakt i njohur botërisht prej Komisionit, është jorelevant dhe në zbatim të kuptimit që ky institut ka sipas parashikimit të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *Faktet e njohura për Komisionin ose faktet e njohura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.* Qartazi kjo dispozitë si edhe simotra e saj në Kodin e Procedurës Civile, neni 13²⁴, përcaktojnë rregullin e panevojshmërisë së provueshmërisë së një fakti për të cilin ekziston kualifikimi se njihet prej Komisionit ose njihet botërisht. Përdorimi, në këtë rast, i këtij koncepti për të shpjeguar marrjen në analizë të një çështjeje që ka qenë në vëmendje të publikut ose dijeni të tij, nuk është në përputhje me parashikimin dhe qëllimin që ka kjo dispozitë, përveç se e ka ngarkuar vendimin e Komisionit për përdorimin jokorrekt të këtij koncepti, me aludime e pretendime për njëanshmëri e paragjykim. Në lidhje me njohjen nga publiku të kësaj ngjarjeje, procedimit penal ndaj S.M., e cila u bë e tillë sepse ky i gjykuar kreu më pas një krim të rëndë ndaj dy shtetasve të huaj që udhëtonin për qëllime turistike në vend, Kolegji çmon se është i pavend etiketimi si një fakt i njohur botërisht sepse vetë ngjarja në vetvete nuk paraqet ndonjë të dhënë me interes për sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat nuk do të kishin nevojë të provoheshin më tej. Kjo ngjarje e njohur publikisht, sigurisht që tërheq vëmendjen e organeve të rivlerësimit për ta analizuar e shqyrtuar atë në kuadër të këtij procesi, por përtej përdorimit të konceptit të faktit të njohur botërisht, sipas parashikimit që ligji ka për faktet që përdoren si prova në këtë proces.

15.3 Përtej këtij arsytimi, Kolegji vëren gjithashtu se në kuptimin formal, Komisioni nuk ka kryer një analizë e shqyrtim autonom për të vlerësuar aftësinë profesionale të subjektit në këtë çështje gjyqësore. Siç rezulton nga shqyrtimi i akteve të gjendura në fashikull në lidhje me këtë çështje, Komisioni ka vendosur vetëm mbi konkluzionet e inspektimit të kryer nga Ministria e Drejtësisë në Gjykatën e Apelit Shkodër, lidhur me çështjen penale në ngarkim të të gjykuarit S.M., konkluzione të cilat janë përcjellë në Komision me shkresën nr. {***}, datë 4.10.2018, të Ministrisë së Drejtësisë. Kolegji konstaton gjithashtu se as vendimet e gjykatave respektive, të cilat janë referuar në vendim, nuk janë administruar prej Komisionit gjatë hetimit administrativ, në mënyrë që ai të kryente një proces vlerësimi të pavarur nga organe e tjera, aq më tepër në kushtet kur inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë nuk është një nga organet ndihmëse të procesit të rivlerësimit, por vetëm një nga burimet e shfrytëzueshme për të kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve, vlerësim i cili duhet të jetë një proces i pavarur e profesional i kryer nga vetë organet e rivlerësimit, në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, por edhe në këndvështrim të arsytimit pajtues që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2/2017²⁵.

²⁴ Neni 13 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

“Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen. Faktet, për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga pala në dobi të së cilës është prezumimi”.

²⁵ Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18.01.2017, lidhur me rolin e organeve ndihmëse konkludohet

15.4 Përtej këtyre vërejtjeve të natyrës procedurale, Kolegji analizoi faktet e ndodhura në kuadër të procedimit në fjalë²⁶, nga të cilat në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar se të gjykuarit e përmendur më lart janë hetuar dhe gjykuar për veprën penale të “vrasjes në rrethana rënduese”, të parashikuar nga neni 79, germa “a” e Kodit Penal dhe të “mbajtjes pa leje të armëve e municioneve”, të parashikuar nga neni 278/2 i po këtij kodi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 28.12.2011, ka vendosur ndër të tjera: *Deklarimin fajtor të të pandehurit S.M. për kryerjen e veprës penale të “vrasjes së kryer në rrethana të cilësuar”, të kryer ndaj të miturit në bashkëpunim dhe, në bazë të neneve 79/a, 25 dhe 51 të Kodit Penal, dënimin e tij me 10 vjet burgim [...]*. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim prej të pandehurve dhe Gjykata e Apelit Shkodër, pjesë e trupit gjykues të së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, në përfundim të gjykimit ka marrë vendimin nr. {***}, datë 04.01.2013, duke vendosur për të gjykuarin S.M.: *Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale të sigurimit të kushteve për të kryer vrasje dhe, në bazë të neneve 80 dhe 52 të Kodit Penal, e dënon me 2 vjet e 6 muaj burgim; b. Deklarimin fajtor të pandehurit për veprën penale “moskallëzim krimi” dhe, në bazë të nenit 300 dhe 51 të Kodit Penal, e dënon me 1 vit e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, e dënon përfundimisht të pandehurin me 4 vjet burgim*. Ndaj këtij vendimi, të pandehurit B. e E.K. kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka vendosur në dhomë këshillimi mospranimin e tij me vendimin nr. {***}, datë 26.02.2015.

15.5 Në analizë të qëndrimeve të Komisionit lidhur me këtë çështje, Kolegji konstaton të njëjtën problematikë si ajo e hasur te çështjet e shqyrtuara më lart, në të cilat Komisioni ka vlerësuar themelin e vendimit të gjykatës që përbën tejkallim të kompetencave të tij kushtetuese e ligjore për sa i përket konkluzionit se subjekti nuk ka bërë një vlerësim të duhur e të harmonizuar të provave, në përputhje me parashikimet e nenit 151, pikat 1 e 2 të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale, duke u përfshirë në këtë mënyrë në një vlerësim të drejtpërdrejtë të interpretimit dhe logjikës së gjyqtarit dhe korrektësisë së vendimmarrjes, pa pasur jo vetëm të drejtën ligjore për ta bërë këtë, por as aktet e domosdoshme mbi të cilat mund të gjykonte në këtë drejtim, duke qenë se ka administruar në lidhje me këtë çështje vetëm raportin e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë. Kolegji gjen me vend të përsëritë edhe në shqyrtimin e kësaj çështjeje të njëjtat dispozita të përmendura në paragrafët më sipër, 10.7 e 10.8, të cilat përjashtojnë të drejtën e organeve rivlerësuese për të gjykuar mbi korrektësinë dhe zgjidhjen në themel të një çështjeje të marrë për shqyrtim.

sa vijon:

“40. Në përfundim, gjykata vlerëson se dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës, dhe garantojnë kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga KPK-ja. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja), të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme”.

²⁶ Vendimi nr. {***}, datë 04.01.2013, i Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimi nr. {***}, datë 28.12.2011, i Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të dhënë për të pandehurin S.M., i janë përcjellë Kolegjit pas kërkesës së gjyqtarës relatores, në zbatim të nenit 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, drejtuar gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për vënien në dispozicion të tyre.

15.6 Në analizë të arsytimit ligjor të vendimit që i përket çështjes së mësipërme, Kolegji konstaton se në të janë përdorur argumente të arsyeshme dhe të logjikshme, si dhe është kryer një analizë e provave të marra, analizë e cila e ka çuar gjykatën në dy konkluzione të rëndësishme: i) nuk ka pasur asnjë provë që tregonte për përfshirje të drejtpërdrejtë për të gjykuarin M. në vrasje; dhe ii) nuk ka rezultuar e provuar as dijenia e tij se thirrja e viktimës prej tij në vendin e takimit ku është kryer vrasja më pas, ka qenë me qëllim vrasjen e tij, madje këtë fakt duket se e pohon edhe vetë vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***}, datë 28.12.2011, që e ka dënuar për vrasje në bashkëpunim të gjykuarin M.²⁷. Pa i hyrë bazueshmërisë në prova të këtyre elementeve të cilat citohen në vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, por në këndvështrim të këqyrjes së arsytimit të vendimit dhe përdorimit të njohurive mbi ligjin, Kolegji çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit është i arsyetuar mbi një analizë të kënaqshme të provave e elementeve përbërëse të veprës penale të vrasjes, si një bazë e arsyeshme, logjike e ligjore që ka shërbyer për konkluzionin se i gjykuari M. nuk ka qenë në rolin e bashkëpunëtorit në vrasjen e kryer dhe se për këtë arsye duhet të ndryshohet kualifikimi ligjor i veprës penale për të, sipas parashikimit të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale.

15.7 Duke ndjekur këtë linjë arsytimi, Kolegji konstaton gjithashtu se kualifikimi i ri ligjor i veprimtarisë së të gjykuarit M., nuk është korrekt dhe në përputhje me ligjin për sa i përket konkluzionit se ai ka konsumuar veprën penale të sigurimit të kushteve për vrasje, sipas parashikimit të nenit 80 të Kodit Penal²⁸. Kolegji arrin në këtë konkluzion pa i hyrë besueshmërisë në prova apo bindjes së brendshme të trupës gjyqësore që ka arritur në këtë konkluzion, por në interpretimin e zbatimin e duhur të kësaj dispozite, e cila, sipas një interpretimi historik, përfaqëson një parashikim ligjor të përfshirë për herë të parë në Kodin Penal të vitit 1996, për të parashikuar në mënyrë të posaçme përgjegjësinë penale për fazën e përgatitjes së veprës penale të vrasjes në një kohë që kjo fazë e kryerjes së një aktiviteti kriminal nuk ishte më e dënueshme për veprat e tjera penale, përveç vjedhjes. Në emër të këtij interpretimi, një individ do të thirret nën përgjegjësi penale për këtë veprë nëse veprimtaria kriminale gjendet në fazën e përgatitjes për vrasje. Për këto arsye, kjo dispozitë nuk mund të gjejë zbatim e të konkurrojë me vetë veprën penale të vrasjes, siç është rasti konkret. Në këto rrethana, aplikimi i kësaj dispozite për të kualifikuar veprimet e të gjykuarit M. gjendet nga Kolegji si i gabuar, duke mbështetur në këtë rast edhe konkluzionin e Komisionit.

15.8 Elementet e tjera të konstatuara nga Komisioni për këtë çështje e që lidhen me kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes, nisur nga data e regjistrimit të saj në Gjykatën e Apelit Shkodër e deri ditën e marrjes së vendimit, apo nisjen me vonesë të seancave gjyqësore, për sa kohë që nuk është e verifikueshme koha reale gjatë së cilës është mbajtur në gjykim çështja dhe roli i subjektit të rivlerësimit në këto vonesa, duke qenë se ai ka qenë me cilësinë e anëtarit dhe jo kryesuesit të trupit

²⁷ Në vendimin nr. {***}, datë 28.12.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër (faqe 10), lidhur me rolin e S.M. në ngjarje, ndër të tjera, arsyetohet:

“Sipas vlerësimit të gjykatës, i pandehuri S.M., duke e çuar viktimën A.L. në vendin ku ka ndodhur vrasja, që është larg vështrimit të njerëzve dhe mundshmërisë për t’u dëgjuar nga të tjerët, dhe duke e ditur paraprakisht se në këtë vend, viktimën do ta prisnin të pandehurit E.K. e B.K., sigurisht ka arritur të parashikojë faktin se viktimës A.L., mund t’i ndodhte diçka e keqe”.

²⁸ Neni 80 i Kodit Penal parashikon se: “Sigurimi i kushteve dhe i mjeteve materiale për të kryer vrasje dënohet me burgim gjer në pesë vjet”.

gjykues, shihen nga Kolegji si jo me relevancë të drejtpërdrejtë në vlerësimin e aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit, qoftë për shkak të rolit të tij në trupën gjykuese, qoftë për shkak të pamundësisë për t'i ngarkuar atij një përgjegjësi e cila ka rezultuar jo nga analizimi prej vetë Komisionit i këtyre detajeve, por vetëm nga inspektimi i kryer nga Ministria e Drejtësisë, raport i cili nuk individualizon përgjegjësinë për këto shkelje të konstatuara dhe as rrethanat në të cilat ato kanë ndodhur.

15.9 Në konkluzion të këtij arsyetimi, Kolegji arrin në përfundimin se lidhur me këtë çështje penale, subjekti do të konsiderohet se ka shfaqur mangësi në drejtim të njohurive ligjore sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa i përket kualifikimit të gabuar ligjor të veprimeve të të gjykuarit S.M. për veprën penale të parashikuar nga neni 80 i Kodit Penal.

- 16.** Në përfundim të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vëren se shkeljet që duhen konsideruar për të bërë një vlerësim të plotë të këtij kriteri lidhen me ato të konstatuara në lidhje me zbatimin e gabuar të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile dhe me zbatimin e gabuar të nenit 80 të Kodit Penal në çështjet e përshkruara më lart. Duke analizuar këto mangësi në raport me të gjitha çështjet e tjera të analizuara prej Komisionit, edhe në kuadër të verifikimit të denoncimeve, e duke pasur në konsideratë edhe raportin e hartuar për çështjet e përzgjedhura me short e të dorëzuara prej vetë subjektit, ngarkesën e tij të punës, vitet e gjata në karrierë, peshën e këtyre mangësive në zgjidhjet e çështjeve konkrete dhe pasojat e ardhura, Kolegji çmon se gjen vend të zbatohet standardi i përdorur nga Gjykata Kushtetuese në interpretimin e saj në paragrafin 54 të vendimit nr. 2/2017, sipas të cilit: *Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).* Në këndvështrim të këtij qëndrimi, Kolegji çmon se mangësitë e konstatuara si më lart nuk janë të një niveli të tillë që të konsiderohen serioze dhe as të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme për njohuritë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

16.1 Në këto kushte, duke konsideruar të gjitha elementet e përshkruara më lart dhe duke pasur në vëmendje që qëllimi i procesit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale nuk është përcaktimi i gradëve apo shkallëve të nivelit të aftësive profesionale, objektiv ky i procesit të vlerësimit periodik që kryhet nga këshillat përkatës në zbatim të ligjit nr. 96/2016, por përcaktimi i faktit nëse subjekti arrin një nivel kualifikues të tillë që të konsiderohet i përshtatshëm për kryerjen e detyrës, Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit duhet të kualifikohet si mjaftueshëm i aftë profesionalisht për të kënaqur kërkesat e nenit 44, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe kërkesës për një nivel minimal kualifikues nën dritën e nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, për pasojë vendimi i Komisionit i cili disponon në mënyrë të ndryshme në këtë drejtim, do të konsiderohet i padrejtë dhe i pambështetur në fakte e në ligj.

D. Pretendime mbi qëndrimin e Komisionit për cenimin e besimit të publikut

17. Në lidhje me këtë konkluzion, në ankim subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si rrjedhojë e vlerësimit në mënyrë të gabuar të të gjitha provave të administruara gjatë hetimit.

17.1 Në vendimin e Komisionit, qëndrimin në lidhje me cenimin e besimit të publikut te drejtësia, e gjejmë të pasqyruar në dy çështje të marra në shqyrtim, tek ajo që i përket procesit civil të denoncuesit A.Gj. dhe te çështja penale që i përket të gjykuarit S.M., te të cilat është përdorur e njëjta shprehje/konstatim për të përkufizuar cenimin e besimit të publikut, përkatësisht: [...] *këto shkelje lidhen me procedurat e gabuara dhe joetike të ndjekura përgjatë një procesi gjyqësor dhe kanë cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.* Me këto shkelje, sipas përmbajtjes së vendimit të Komisionit, kuptohen orientimi/sugjerimi për sjelljen e një prove te çështja Gj. dhe kohëzgjatja e gjykimit dhe zhvillimi i seancave me vonesë te çështja e S.M., si elemente të cilat janë evidentuar përtej gjetjeve që lidhen me mangësitë profesionale të cilat u analizuan më lart e që nuk mund të përbëjnë elemente që rimerren në shqyrtim edhe në këndvështrim të cenimit të besimit të publikut.

Në përfundim të vendimit të Komisionit konstatohet se prej tij është marrë një qëndrim në lidhje me cenimin e besimit të publikut, sipas të cilit ai ka konkluduar se: *Nga vlerësimi tërësor dhe kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ndaj, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

17.2 Në analizë të këtij qëndrimi të Komisionit, Kolegji konstaton se elementet që Komisioni ka përdorur për të arritur në këtë konkluzion, nuk janë të tilla që meritojnë të ngrihen në nivelin e një sjelljeje të subjektit që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Siç edhe është arsyetuar më lart, nga verifikimi i akteve, nuk rezulton i qartë roli dhe aktiviteti i subjektit të rivlerësimit në orientimin e një pale ndërgjyqëse për të paraqitur një provë, orientim i cili pretendohet se është kryer jashtë seancës gjyqësore. Në këto rrethana, do të ishte joproporcionale që apriori të gjykohej se kjo ndërhyrje, *së pari* të ketë ndodhur pikërisht siç pretendohet prej denoncuesit; të vlerësohej pa ditur realisht rrethanat dhe kontekstin në të cilin gjyqtari ka dhënë këtë orientim, gjithmonë nëse orientimi është dhënë; të vlerësohej në versionin se ai ka ndodhur, nëse ka qenë një veprim jo i përshtatshëm për të favorizuar palën e paditur dhe shfaqje e paragjykit të çështjes apo një veprim i natyrës organizative e administruese të procesit edhe nën frymën e parashikimeve ligjore të mëparshme mbi rolin aktiv të gjykatës në një proces civil, në funksion të dhënies së një vendimi mbështetur në të gjitha provat që konsideroheshin të nevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe dhënien e drejtësisë si qëllim në vetvete. Vetëm pasi të kryhej një analizë si ajo e parashtruar më lart, do të mund të gjykohej edhe qëndrimi tjetër i mbajtur prej Komisionit se subjekti pas këtij veprimi duhej të dorëhiqej prej trupës gjykuese që gjykonte çështjen, në këndvështrim të nenit 72, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Civile, por në kushtet kur e gjithë kjo panoramë nuk është e plotë, Kolegji ndryshe nga Komisioni çmon se ky defekt për aq sa evidentohet, nuk mund të konsiderohet i asaj natyre që të meritojë diskutimin mbi cenimin e besimit të publikut te drejtësia.

17.3 Elementi tjetër mbi të cilin është mbështetur ky konkluzion, lidhet me kohëzgjatjen e kohës së gjyqimit të çështjes gjyqësore që i përket të gjykuarit S.M., prej 10 muajsh nga shortimi i saj, e cila sipas qëndrimit të Komisionit është përtej afatit 9-mujor që normon vendimi i KLD-së nr. 261/2, datë 14.04.2010, si edhe me faktin që të gjitha seancat gjyqësore kanë filluar me vonesë në shkelje të rregullit 8 të Kodit të Etikës Gjyqësore, miratuar me Konferenca Gjyqësore në datën 08.12.2006, si edhe me nenin 4 të vendimit nr. 238/1/b, datë 24.12.2008, të KLD-së.

Në analizë të këtij qëndrimi, Kolegji vlerëson se natyra e tyre si shkelje, duke abstraguuar faktin se këto shkelje janë konstatuar vetëm nga raporti i inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë dhe jo nga verifikimi i drejtpërdrejtë i dosjes gjyqësore prej Komisionit, janë elemente që lidhen me aftësinë organizative të magjistratit të ngarkuar me gjykimin e çështjes dhe, në këtë kontekst, përgjegjësia principale mbi këto zvarritje bie mbi gjyqtarin relator/kryesues të çështjes, i cili është përgjegjës për organizimin e punës dhe vendosjen apo përcaktimin e kohës për gjykim të një çështjeje dhe në këtë kompetencë të tij nuk mund të ndërhyjnë gjyqtarët anëtarë të trupës, të cilët thirren në gjykim vetëm pasi relatori i çështjes e ka përgatitur dhe thirrur seancën gjyqësore, për këtë arsye nuk mund të diskutohet për përgjegjësi të subjektit për këtë shkak, duke qenë se ai ka pasur rolin e anëtarit të trupës gjyqësore. Në vijim të këtij arsyetimi, ndonëse jo krejt jashtë përgjegjësisë, trupa gjyqësore ka një peshë më të ulët specifike se ajo e kryesuesit në mbarëvajtjen e kohës gjyqësore dhe mirorganizimin e seancave, për sa kohë që nuk kemi evidenca se pikërisht sjellja e subjektit ka qenë shkak i shkaktimit të vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore. Përpos këtij argumenti, nuk kemi as evidenca apo të dhëna për arsyet e vonesave të seancave gjyqësore për t'i dhënë kësaj mangësie peshën dhe vlerën e duhur në gjykimin e sjelljes së subjektit edhe në këndvështrim të faktit se si këto vonesa do të perceptoheshin nga vlerësimi i publikut.

17.4 Në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon se elementet e mësipërme, të përdorura si bazë për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë, nuk kanë një natyrë e peshë të tillë, të aftë për të shkaktuar perceptimin e publikut se drejtësisë nuk funksionon. Kolegji gjithashtu e sheh me vend të nënvizojë faktin se qëndrimet që mbahen në raport me këtë dispozitë, duhet të jenë të arsyetuara e të analizuara, duke shpjeguar shkeljet dhe mënyrën se si ato cenojnë potencialisht besimin e publikut, me qëllim shmangien e subjektivizmit dhe vlerësimit sipërfaqësor të këtij shkak shkakimi. Vetë fakti që ligji nr. 84/2016e ka lidhur zbatimin e nenit 61, pika 5 si një rast shkarkimi me vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve apo vlerësimin tërësor të procedurave sipas parashikimit të nenit 2, pika 4 e këtij ligji, tregon qartë synimin për të pasur një vlerësim sa më objektiv dhe të arsyeshëm në zbatimin e këtij kriteri.

17.5 Në përfundim, Kolegji arrin në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë nuk qëndron, si i pambështetur në fakte e në ligj dhe se, edhe për këtë qëndrim, vendimi i Komisionit duhet të ndryshohet.

- 18.** Në përfundim të gjithë sa më sipër, Kolegji ka konkluduar në lidhje me të gjitha çështjet e shqyrtuara si më poshtë.

I. Lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë

Kolegji vlerëson se konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë kriter nuk është pasojë e analizimit në mënyrë të drejtë e të gjithanshme të të gjitha fakteve e provave që kanë rezultuar nga hetimi

administrativ dhe as i mbështetur në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë kontrollin dhe vlerësimin e këtij kriteri. Sipas vlerësimit të Kolegjit, deklarimet e pasakta të kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të pasurisë në lidhje me pakësimet e gjendjes së likuiditeteve në *cash*, për sa kohë që nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar të gjitha shpenzimet e pasuritë e krijuara në vite, nuk mund të konsiderohen se janë rrethana të mjaftueshme për të konkluduar se gjendemi në ndonjë prej parashikimeve ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe as ato të parashikuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por se situata faktike konstatohet se përmbush nivelin e kërkuar të provueshmërisë së parashikuar nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti duhet të konsiderohet se ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e kriterit të pasurisë.

II. Lidhur me kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale

Kolegji, pasi analizoi të gjitha gjetjet e paraqitura në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit në lidhje me kontrollin e këtij kriteri nuk është rezultat i vlerësimit të drejtë dhe në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi të gjetjeve të konstatuara. Kolegji konstaton se disa prej tyre përfaqësojnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri, përpos gjetjeve që u konstatuan të pambështetura në ligj dhe fakte sipas vlerësimit të trupit gjykues. Kolegji konstatoi gjithashtu se gjetjet e Komisionit të cilat u konsideruan si të bazuara, ishin të tilla që nuk mjaftonin për të kualifikuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit si nën nivelin minimal kualifikues, për pasojë, në analizë të të gjitha rrethanave të çështjes dhe kuadrit ligjor në fuqi, arriti në konkluzionin se zbatimi i nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton shkarkimin nga detyra për subjektin, është i gabuar. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të paktën nivelin minimal kualifikues në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale për efekt të këtij procesi, në kuptim e zbatim të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

III. Lidhur me konkluzionin për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë

Kolegji gjithashtu e gjeti të padrejtë qëndrimin e Komisionit dhe si një vlerësim sipërfaqësor e të paargumentuar të rrethanave të konsideruara se kanë shërbyer si bazë për mbajtjen e këtij qëndrimi. Kolegji konstaton se në çfarëdo vlerësimi të këtyre rrethanave, ato nuk mund të shërbejnë si një bazë e mjaftueshme dhe e vlerësueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se aplikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si kriter për shkarkimin e subjektit nga detyra, nuk gjendet i mbështetur në prova e në ligj.

19. Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit plotëson në mënyrë kumulative të tria kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përfshirë edhe vlerësimin e Komisionit për kontrollin e figurës dhe, në zbatim të kësaj dispozite, duhet të konfirmohet në detyrë. Në këto kushte, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra e gjyqtarit, është marrë në vlerësim jo të duhur të fakteve e provave të administruara gjatë hetimit e

në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit, për pasojë ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 155, datë 10.6.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha dhe konfirmimin e tij në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 23.10.2020.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Ina RAMA

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi